



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 24 DHE 30 TETOR 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 24. I 30. OKTOBRA 2024. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR**  
**2024**

## **Rendi i ditës**

1. Debat parlamentar për skandalet dhe keqmenaxhimi në Korporatën Energjetike të Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Parlamentarna debata o skandalima i lošem menadžiranju u Energetskoj korporaciji Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës sonë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës është kërkuar kjo seancë e jashtëzakonshme për të debatuar lidhur me skandalet dhe keqmenaxhimin në Korporatën Energjetike të Kosovës, si dhe për këtë seancë është propozuar edhe një rezolutë, të cilën do ta hedhim në votim.

### **1. Debat parlamentar për skandalet dhe keqmenaxhimin në Korporatën Energjetike të Kosovës**

Në emër të deputetëve nënshkrues që e kanë thirrur këtë seancë do ta ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetin Arben Gashi, që ta prezantojë dhe t'i adresohet Kuvendit.

Urdhëroni, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Në përputhje me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafi 6, neni 68 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emër të 43 deputetëve nënshkrues kemi thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme me qëllim të diskutimit lidhur me skandalet dhe keqmenaxhimin në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës.

Kjo seancë është e domosdoshme për zhvillimin e një debati të gjerë e parlamentar lidhur me situatën alarmante të shkaktuar nga keqmenaxhimi dhe ndërhyrjet e jashtëligjshme në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës, të cilat ndërhyrje kanë dëmtuar funksionimin dhe integritetin e kësaj ndërmarrjeje jetike për vendin.

Kjo seancë ka për qëllim që Kuvendi të adresojë këto shqetësime dhe të zhvillojë një debat të hapur për masat që duhen të merren për të përmirësuar menaxhimin në KEK. Për të rritur transparencën dhe për të ndaluar ndërhyrjet e paligjshme, Kuvendi duhet të sigurojë që KEK të operojë sipas standardeve të larta profesionale dhe t'i respektojë ligjet e Republikës së Kosovës. Çështje specifike që kërkojmë të trajtohen gjatë këtij debati janë: skandalet me tenderët njëburimorë dhe mungesa e konkurrencës në prokurimit publik në KEK.

Një nga çështjet më serioze që ka dalë nga hetimet e Komisionit Hetimor Parlamentar për hetimin e menaxhimit me energji elektrike gjatë krizës energjetike, si dhe nga gjetjet e Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me tenderimet njëburimore të zhvilluara në KEK, po ashtu dhe nga raportet dhe publikimet mediatike është dhënia e tenderëve njëburimorë. Rezulton se

praktikat e prokurimit publik të realizuara gjatë periudhës 2021-2024 kanë dështuar të respektojnë parimet e transparencës dhe të konkurrencës së drejtë, duke krijuar terren për korrupsion dhe favorizim të subjekteve të caktuara. KEK si ndërmarrje publike, më e madhja e vendit, është përgjegjëse për përdorimin e drejtë të fondeve publike, por proceset e tenderimit kanë treguar keqmenaxhim dhe ndërhyrje të jashtëligjshme.

Çështja e dytë, e cila duhet të diskutohet, është shitblerja e energjisë elektrike dhe ndikimi financiar në financat e vendit. Shitblerja e energjisë elektrike është një sektor që ka ngritur shqetësime të mëdha. Raportet tregojnë se KEK ka lidhur kontrata jo të favorshme që kanë dëmtuar stabilitetin financiar të korporatës. Procesi i tregtimit të energjisë elektrike është bërë pa transparencë të mjaftueshme, duke krijuar dyshime për parregullsi serioze.

Kjo seancë do të na ndihmojë në sqarimin e këtyre çështjeve dhe përgjegjësitë për një menaxhim më të mirë. Duhet të kemi në mendje po ashtu faktin se ka vendime të formës së prerë të gjykatës lidhur me tregtinë me energji elektrike, ku dëmi llogaritet dhjetëra apo qindra milionë euro.

Ndërhyrja e personave jashtinstitucionalë në menaxhimin e KEK-ut, dhënia e tenderëve, punësimet dhe tregtinë me energji. Kjo është një çështje tjetër që po ashtu duhet të diskutohet. Ndërhyrjet e personave të paautorizuar në menaxhimin e KEK-ut janë një problem madhor. Raportet tregojnë se individë pa asnjë rol formal në KEK kanë ndikuar në dhënien e tenderëve, punësimin dhe tregtinë me energji, duke shkaktuar favorizime dhe shkatërruar integritetin institucional.

Një çështje tjetër që duhet të diskutohet dhe për të cilat Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të marrë qëndrimin e vetë është: përfshirja e personit të quajtur Dejona Mihajli si koordinatore e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ndërhyrjet e paligjshme në KEK, përfshirë punësimet e paligjshme.

Sipas raportimeve publike personi i quajtur Dejona Mihajli, me titullin koordinatore e Lëvizjes Vetëvendosje, ka ndërhyrë në mënyrë të paligjshme në menaxhimin e KEK-ut, duke ndikuar në dhënien e tenderëve, në tregtimin e energjisë elektrike, si dhe duke shkaktuar një valë punësimesh të jashtëligjshme, për të cilat ka edhe kallëzim penal nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Këto veprime kanë dëmtuar meritokracinë, transparencën dhe besimin qytetar në ndërmarrjen publike. Për këtë arsye, në emër të deputetëve nënshkrues kemi propozuar dhe një rezolutë:

Në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.8 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e tij të jashtëzakonshme të mbajtur më 24 tetor 2024, me propozim të deputetëve nënshkrues i propozohet kjo:

## Rezolutë

1. Kuvendi i Kosovës kërkon nga organet kompetente që të vazhdojnë hetimet e plota dhe të thelluara për skandalet e KEK-ut, duke përfshirë keqmenaxhimin e tenderëve njëburimorë dhe mungesën e konkurrencës në prokurimin publik. Të gjitha shkeljet e konstatuara të ndiqen penalisht.
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe Bordi i KEK-ut të raportojnë për kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike për vitet 2021 - 2024, duke përfshirë kushtet e favorshme për palët e treta dhe ndikimin financiar në financat publike. Kuvendi obligon organet përkatëse që të rishikojnë këto kontrata dhe të mbrojnë interesin publik, të ndjekin dhe të eliminojnë secilën parregullsi. Kuvendi kërkon nga autoritetet kompetente të hetojnë ndërhyrjen e personave të paautorizuar në menaxhimin dhe vendimmarrjen e KEK-ut, veçanërisht në lidhje me dhënien e tenderëve, tregtinë e energjisë dhe proceset e punësimit.
3. Të merren masa konkrete për të ndaluar ndërhyrjet e paligjshme dhe për të siguruar një menaxhim transparent dhe të pavarur në KEK.
4. Kuvendi kërkon një hetim të plotë për rolin e personit të quajtur Dejana Mihali dhe çdo personi tjetër që ka ushtruar ndikim të jashtëligjshëm në menaxhimin në KEK dhe në proceset e rekrutimit, duke përfshirë punësimet e jashtëligjshme.
5. Kuvendi e obligon Bordin e KEK-ut dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e energjisë që të rrisin transparencën në të gjitha proceset e prokurimit dhe tregtisë së energjisë, duke përfshirë publikimin e kontratave dhe raportimin e detajuar mbi performansën financiare dhe operacionale.
6. Kuvendi rekomandon që Qeveria e Kosovës të marrë masa për përmirësimin e qeverisjes në KEK, duke emëruar një bord të pavarur dhe profesionist, me qëllim që të sigurohet funksionimi efikas dhe i përgjegjshëm i ndërmarrjes.
7. Kuvendi kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe Bordi i KEK-ut që të raportojë çdo tre muaj për situatën në KEK, përfshirë masat e marra për përmirësimin e menaxhimit të prokurimit publik, transparencën dhe procesin e punësimeve.

Pra, kjo është rezoluta që i propozohet sot Kuvendit dhe për të cilën jemi të hapur për diskutime, plotësime, ndryshime dhe amendamente, sipas kërkesave që mund të vijnë nga grupet parlamentare. Faleminderit, i nderuar kryetar!

KRYETARI: Kjo ishte rezoluta, e cila u paraqit në Kuvend, tash është radha e Partisë Demokratike. Në emër të Grupit flet kryetari Tahiri.

Urdhëroni, zoti Tahiri!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që vlen të theksohet është që nga 23 prilli i vitit 2020, Korporata Energjetike e Kosovës udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje. Pra, ka qenë Qeveria Kurti 1, ku me datë 23 prill të vitit 2020 emëron bordin e ri dhe drejtorin e ri të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Korporata Energjetike e Kosovës është kompania publike më e madhe në vend. Buxheti vjetor i kësaj korporate sillet rreth 150 milionë. Ndërsa, për vitin 2024 vlen të theksohet që planifikimet janë që buxheti i kësaj korporate të jetë rreth 204 milionë. Pra, tash e pesë vjet kemi hyrë në vitin e pestë ku Korporata Energjetike e Kosovës menaxhohet nga njerëzit e deleguar nga Lëvizja Vetëvendosje. Pra, nëse e shohim në total buxheti që është shpenzuar për këto vite e kalon shifrën edhe 600 milionë euro, që në fakt nuk e dimë saktësisht nga kush janë menaxhuar. A janë menaxhuar nga Bordi, nga drejtori, nga Dejana, nga Nagipi apo nga Martini?

Pra, për të kuptuar mirë punën e KEK-ut, duhet munduar të shohim një fotografi më të gjerë të krejt këtij procesi. Gjatë katër vjetëve, apo në vitin e pestë që kemi hyrë të drejtimit të KEK-ut nga Lëvizja Vetëvendosje, i kemi evidentuar në këtë Kuvend që janë dhënë diku rreth 105 milionë euro kontrata njëburimore për dy vjet. Po flasim vetëm për vitin 2022 dhe vitin 2023, jo për vitin 2020, jo për vitin 2021, as për vitin 2024. D.m.th. vetëm për vitin 2022 dhe vitin 2023 kjo korporatë ka kontraktuar rreth 105 milionë euro kontrata njëburimore.

Kjo situatë nuk ka ndodhur asnjëherë në Korporatën Energjetike të Kosovës. E them me përgjegjësi të plotë. E them duke u bazuar në një hulumtim të gjerë që e kemi bërë për funksionimin për më se dhjetë vjet të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Pra, duke qenë Korporata Energjetike e Kosovës nën drejtimin e Lëvizjes Vetëvendosje ka ndodhur shtrenjtimi qind për qind i energjisë elektrike, paçka se e kemi dokumentuar në këtë Kuvend që nevojat tona të brendshme janë mbuluar pothuajse nëntëdhjetë për qind nga prodhimi ynë i brendshëm i energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike që sot qytetarët e Kosovës paguajnë, që është rritur gjatë kësaj periudhe të drejtimit të KEK-ut nga LVV-ja, ka shkuar rreth 115 për qind.

Ju e dini thënien e famshme të kryeministrit Kurti që ne flemë në thëngjill dhe nuk ka mundësi që të paguhet ky çmim kaq i shtrenjtë i energjisë elektrike, i cili është duke u paguar tani për vitet paraprake sa ishte Kryeministri Kurti në opozitë.

Çështje tjetër që është shumë e rëndësishme të përmendet është edhe çështja e Counter Global dhe gazit amerikan, që është pjesë e kësaj skeme energjetike të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po jua përkujtoj që në rast se do të shkonim sipas planifikimeve për ndërtimin e TC Kosova e Re, sot Kosova do të ishte në prag të lëshimit të termocentralit të ri, e që do të paguante 80 euro për megavat. Pra, nëse kontrata nuk do të shkëputej nga Qeveria Kurti për ndërtimin e TC Kosova e Re, sot Kosova do të kishte furnizim të rregullt me energji elektrike me çmim 80 euro/MW. A e dini deri sa e kemi blerë megavatën gjatë kësaj periudhe, deri 800 euro. Pra, 800 euro e kemi blerë megavatën e energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar, në bursën ndërkombëtare, ndërsa e kanë anuluar një kontratë për të cilën kemi dalë edhe në Arbitrazh, e kemi humbur edhe rastin e Arbitrazhit dhe për të cilin kemi paguar edhe njëzet milionë euro shtesë.

Po ashtu, përtej kësaj, duhet theksuar edhe faktin që ka qenë Qeveria Kurti, e cila e ka bllokuar projektin e gazifikimit të Kosovës, apo sjelljen e gazpërçuesit nga investimet amerikane, pra nga Greqia nëpërmjet Maqedonisë në Republikën e Kosovës. Pra, po ashtu një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sistemit tonë energjetik në vendin tonë bllokohet nga Lëvizja Vetëvendosje.

Ajo që është e rëndësishme të përmendet po ashtu, gjatë kësaj periudhe që kam hasur, ka qenë edhe çështja e shpronësimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për vëmendjen tuaj, shpronësimet në KEK i paraprijnë nga vlerësimi i një operatori të jashtëm apo një kompanie të jashtme që e bën për Korporatën Energjetike të Kosovës. Pra, KEK-u nuk vendos çka të shpronësojë dhe si të shpronësojë, mirëpo shpronësimi ndodh si rezultat i një studimi, si rezultat i një vlerësimi të ekspertëve në bazë të rregullave të përcaktuara nga Banka Botërore. Ata ekspertë apo ajo kompani vlerëson se cila duhet të jetë sipërfaqja që KEK-u duhet ta shpronësojë për prodhimin e energjisë elektrike, le të themi, në katër ose pesë vitet e ardhshme për nxjerrjen e thëngjillit.

Çka ka ndodhur në shpronësim? Pra, kompania e cila është kontraktuar nga Korporata Energjetike e Kosovës del me një vlerësim preliminar të qartë, ku thotë, po flas për një raport të dorëzuar në vitin 2022, thotë: Shpronësimi duhet të ndodhë në pronat në sasi rreth shtatëdhjetë hektarë tokë dhe kostoja e shpronësimit të këtyre shtatëdhjetë hektarëve është 16,2 milionë euro. Pra, ky është vlerësimi i ekspertëve që ndodh në Korporatën Energjetike se çka duhet të shpronësohet për prodhimin e energjisë elektrike përmes thëngjillit në vitet në vijim.

Çka ndodh këtu? Ky elaborat, apo ky vlerësim, zakonisht mund të ndryshojë rreth pesë për qind më shumë apo më pak. Kjo është ajo vlera që mund të ndryshojë. Çka ndodh këtu? Për shkak se duhet të shpronësohet një parcelë që është shumë më larg se kjo, që është në vlerë prej 1.6 hektarë, e që është pronë e familjes së një deputeti të Lëvizjes Vetëvendosje në këtë Kuvend, shtohet edhe shpronësimi jashtëligjshëm i 28 hektarëve. Pra, edhe 28 hektarë shtohen, sepse duhet të shpronësohet prona e një deputeti dhe familjes së tij, që është rreth 1,6 hektar dhe shtohen edhe 28 hektarë, që është rreth dyzet për qind e sipërfaqes shtesë, shtohet pikërisht me këtë vlerësim.

Pastaj, a e dini cila është vlera e këtij shpronësimi? Pra, nga shtatëdhjetë hektarë që ishte 16,2 milionë euro, edhe plus këta 28ha që duhet shpronësuar pikërisht për shkak të asaj parcele që është e rëndësishme ta shpronësojë Korporata Energjetike e Kosovës? Është 32 milionë euro.

Pra, për 28 ha, apo për dyzet për qind që e shtojnë, shtohen edhe gjashtëmbëdhjetë milionë euro të tjera. 32 milionë euro.

E ftoj Prokurorinë, e ftoj Prokurorin e Shtetit, i ftoj hetuesit ta parandalojnë këtë krim makabër dhe këtë plaçkë që ndodh me buxhetin e Korporatës Energjetike të Kosovës. Kjo është në prag të një vendimi. I ftoj institucionet tona të drejtësisë që t'i vihen prapa kësaj afere ku dëmtohet buxheti i Kosovës rreth gjashtëmbëdhjetë milionë euro.

Adresa për krejt këtë çështje, a e dini kush është? Është ish-drejtori i Zyrës Ligjore në Korporatën Energjetike të Kosovës, asamblist në Prishtinë i Lëvizjes Vetëvendosje, ish-këshilltar i ministrit Arben Vitija, z. Milot Podvorica, i cili sot shërben si noter i emëruar nga ministrja e Drejtësisë.

Pra, koka e këtij krimi të madh në Korporatën Energjetike është noteri i tanishëm Milot Podvorica, i emëruar nga ministrja e Drejtësisë, i cili i shton edhe gjashtëmbëdhjetë milionë euro shtesë pra për shpronësime. Pra, dyfish e dëmton buxhetin e Kosovës edhe për gjashtëmbëdhjetë milionë euro shtesë, për shkak që deputetit tonë, kolegut tonë nga Lëvizja Vetëvendosje duhet t'i shpronësohet prona, edhe gjashtëmbëdhjetë hektarë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Abuzimet në këto pesë vjet e gjysmë në Korporatën Energjetike janë jashtëzakonisht të mëdha. Janë njëqind milionë euro me kontrata njëburimore për dy vjet, janë rreth tridhjetë milionë euro me shpronësime, pra janë mbi dyqind familjarë të evidentuar nga mediat, familjarë të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje e kështu me radhë.

Pra, krejt ky abuzim që ka ndodhur gjatë kësaj periudhe duhet t'i vijë fundi. Kapaku i krejt këtij abuzimi, pa dyshim është Dejona Mihali. Dejona Mihali e cila na tregon kur duhet blerë energji



elektrike, kur duhet shitur energji elektrike. Pra, mesazhi i famshëm i saj me Ergysin e tregon qartë që kjo korporatë apo këto gjashtëqind milionë euro të shpenzuara nga kjo korporatë për këto vite sa ka qenë në pushtet Lëvizja Vetëvendosje janë të drejtuara nga një person i vetëm, pra nga Dejana Mihali. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kjo ishte paraqitja e PDK-së. Tash e ka radhës Lidhja Demokratike. Driton Selmanaj flet në emër të Grupit të LDK-së.

**DRITON SELMANAJ:** Mirë se u riktheve, i nderuar kryetar!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Ne në fakt në vend se sot të diskutojmë për kapacitetet e reja energjetike në Kosovë, në vend se të diskutojmë për eventualisht sjelljen e gazit në Prishtinë dhe për mundësitë e ndërtimit të kapaciteteve të reja edhe si burim energjie, duke shfrytëzuar edhe gazin, ne sot flasim për kaosin, kaosin energjetik, kaosin sesi Lëvizja Vetëvendosje e ka sjellë gjendjen e rëndë në KEK.

Andaj, ne si LDK shprehim shqetësimin tonë për gjithë atë çfarë ka ndodhur e çfarë po ndodh në këtë korporatë, e cila është vitale për shtetin e Kosovës. Ne, qysh me kohë, kemi ngritur shqetësimet tona, jemi bërë pjesë e më shumë se pesë debateve parlamentare, kemi udhëhequr komisionin hetimor, po ashtu kemi bërë edhe kallëzim penal, por fatkeqësisht asnjë përgjegjësi të vetme politike nga kjo Qeveri.

Dua t'ju kthej pak në kujtesë, nëse e mbani mend z. Kurti kur thoshte që populli i Kosovës dhe njerëzit e Kosovës po rrinë mbi thëngjill, mbi linjit dhe po paguajnë shumë shtrenjtë. Me të ardhur në pushtet, krejt çka ndodhi, ndodhi që energjia elektrike në Kosovë u rrit qind për qind. U harruan të gjithë ato çka u thanë, u harruan të gjitha ato premtime, ndërkohë që faktet natyrore nuk ndryshuan, po ndryshuan sjelljet politike.

E dyta, akuzonin për politizim bordesh, akuzonin për politizim edhe të institucioneve si ndërmarrje publike. Dhe çfarë bënë? Njeriun e parë që e dërguan për të udhëhequr ose në pozitën e kryeshefit ekzekutiv në KEK, dërguan personin që udhëhiqte Komitetin për energji në Lëvizjen Vetëvendosje, z. Nagip Krasniqi, i cili sot është prapa grilave.

Dua të kthej pak po ashtu në kujtesë edhe çështjen e komisionit hetimor, i cili kishte nxjerrë disa konstatime, por për fatin e mirë ato konstatime vazhdojnë të jenë baza kryesore e aktakuzës së Nagip Krasniqit.

Ne me kohë kemi thënë që është e papranueshme, është e paligjshme, është kundër edhe praktikës, por edhe kundër ligjeve të aplikueshme në Kosovë që vendimet e organeve të pavarura të mos respektohen. Nëse ju kujtohet atëkohë kemi thënë që ZRRE-në e ka informuar të gjitha institucionet përkatëse që të mos tregojnë energji me një kompani, e cila nuk kishte një licencë

në Kosovë, kompaninë HSE. Por, të gjitha institucionet e tjera, mekanizmat e tjerë e merrnin parasysh këtë rekomandim, ose jo rekomandim, por këtë urdhër të ZRRE-së. I vetmi që nuk e merrte parasysh, ishte kryeshefi i KEK-ut, e që tash po del që nuk ka qenë i vetëm, por ka qenë edhe me njerëz të tjerë brenda Lëvizjes Vetëvendosje që i kanë dhënë urdhra si duhet të silllet ai.

Përpos asaj, përpos tregtimit me energji me një kompani, e cila nuk ka pasur licencë, ne patëm ngritur shqetësimin edhe për tregti me energji edhe me kompani të dyshimta, edhe me çmime të larta, në krahasim ndoshta më të lartat në krahasim me ato të cilat ishin në bursat ndërkombëtare.

Po ashtu, krejt këtij skandali ose krejt këtij kaosi në fushën e energjetikës në Kosovë i shtohet edhe një person tjetër e që është Martin Berishaj, e që informatat tashmë edhe publike janë që brenda pak ditësh ai ka nxjerrë nga bankat e Kosovës mbi një milion e gjysmë euro, ndërkohë që institucionet e Kosovës akoma nuk janë vënë në lëvizje sa duhet dhe si duhet për të parë si, kush e nga janë burimi i këtyre të ardhurave. Atë që ne e kemi parë, burim i të ardhurave është GEN me seli në Beograd.

Përsëri, asnjë përgjegjësi politike, asnjë përgjegjësi penale në rastin konkret. Përkundrazi, Kryeministri Kurti del në mbrojtje të tyre, sikur të jetë avokat dhe me tërë kapacitetin e tij provon t'i mbrojtë, edhe ata që ne jemi të bindur që kanë abuzuar me paranë publike dhe me pozitën që ata kanë pasur, qoftë brenda KEK-ut, qoftë në diplomaci.

Thënë të drejtën, krejt kjo na është konfirmuar edhe në një rast tjetër. Nëse e mbani mend, ne e kemi ftuar për intervistim Besim Imerin. Besim Imeri ka qenë drejtor ose udhëheqës i njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike brenda KEK-ut. Besim Imeri, ndjesë që po e përmend me emër, por ai ka pasur funksion publik, ka qenë një nga familjarët e një deputeti të Lëvizjes Vetëvendosje dhe është proklamuar si prurje në Lëvizjen Vetëvendosje dhe ai në momentin kur i sheh parregullsitë e mëdha që ndodhin në KEK, ai largohet.

Ai largohet, sepse thotë kështu, me dy arsye. Arsyeja e parë thotë: ka pasur kontrata të numërta, që nuk janë raportuar fare në këtë njësi. D.m.th. KEK-u ka nënshkruar kontrata me kompani të ndryshme, ndërkohë që institucionet kryesore që është dashur që t'i raportojnë, ata që kanë qenë njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike, atij nuk i kanë raportuar fare. Pretendimi i dytë i tij është që KEK-u dhe Nagip Krasniqi ka shfrytëzuar edhe xhirollogari të tjera për transaksione financiare përtej atyre xhirollogarive që ishin në marrëveshje të KEK-ut me palë të tjera. Kjo është arsyeja pse është larguar nga KEK-u.

Tash, po del që ai person qenka me integritet, sepse e ka detektuar herët. Aty është një skemë e organizuar kriminale dhe si i tillë ai duhet të abstenojë ose duhet të ikën nga kjo përgjegjësi dhe ka bërë mirë. Por, nuk e keni idenë se çfarë përkushtimi të madh kishte Lëvizja Vetëvendosje atëkohë që të mos lejonte që z. Besim Imeri të vinte dhe të raportonte në komisionin hetimor.

Ata refuzonin. Herë nuk vinin në komision, herë kur vinin sabotonin dhe në fund sabotuan edhe me raportin, dhe tash po del krejt qartë. Duke e parë se çfarë ka ndodhure brenda KEK-ut, atëherë po del shumë e qartë që ata nuk kanë dashur që vërtet Besim Imeri t'i ofrojë të gjitha të dhënat që i ka pasur në dispozicion, sepse jam i bindur që pas kësaj nuk do të përfundonte prapa grilave vetëm zoti Nagip Krasniqi.

Po duket që është një skemë, po them, një grup më i madh i njerëzve. Kontrata sekrete ose kontratat e negociuara, por që ne i quajmë kontrata sekrete, janë për nga numri më i madh në KEK. Domethënë, nga viti 2021-2024 i kemi 131 kontrata sekrete në vlerë monetare mbi 105 milionë euro.

Ndërkohë, i kemi edhe 6 aneks kontrata të tjera, po ashtu edhe këto janë të negociueshme, ose sekrete, sepse nuk kanë dashur që të shpallin procedura të prokurimit nga frika që mund t'i marrë ai që meriton. Por, këtyre u është dashur që t'i marrë ai që u duhet këtyre, sepse më pas pazaret e tyre janë më të lehta.

Cila është natyra e këtyre kontratave për sigurim të objekteve? Pjesa më e madhe e këtyre kontratave është për sigurim të objekteve. Çfarë kontratash të tjera ka. Është transporti i punëtorëve. Në shumicën e rasteve, në shumicën e një numri të madh të kontratave të tjera njëburimore janë përzgjedhja e kompanive për t'i bartur me autobus punëtorët e KEK-ut.

Edhe këto po u dashka të bëhen me kontrata sekrete, sepse paska pak autobusë në Kosovë. Paska pak kompani në Kosovë që bartin punëtorë. Sigurimin shëndetësor të punëtorëve të KEK-ut e kanë bërë me kontratë sekrete. Po ashtu, po them, paskemi pak kompani dhe do të duhej patjetër me...

Pastrimin e objekteve administrative që janë në kuadër të KEK-ut. Edhe këto i kanë bërë me kontrata sekrete. Dhe, për të shkuar kulmi në krejt, kontratë sekrete bëjnë edhe për blerjen e kartolinave për Vitin e Ri. Abuzim marramendës. Abuzim skandaloz. Abuzim të pakuptimtë. Shumë të pështirë, janë të gjendje të bëjnë.

Mbi 108 milionë euro kap shifra totale që KEK dhe shpura e KEK-ut edhe e anëtarëve që janë aty përreth kanë zgjedhur që të abuzojnë me paranë publike tani në mënyrë të strukturuar, përmes korrupsionit, që unë kam thënë disa herë, korrupsion të strukturuar. Përsëri po e them, asnjë përgjegjësi politike nga ana e kryeministrit, së paku që t'i thërrasë në përgjegjësi.

Kjo praktikë, normalisht, që është në kundërshtim me ligjin. Kjo praktikë, normalisht, që është në kundërshtim edhe me Kushtetutën. Sidomos kjo e çështjes së kontratave njëburimore. Ne kemi nenin 10 të Kushtetutës, i cili parasheh në Kosovë që të kemi treg të lirë dhe treg të konkurrencës, ekonomi të lirë të tregut, por Lëvizja Vetëvendosje ka zgjedh të kundërtën.

Prandaj, LDK është e bindur që përtej zotit Nagip Krasniqi, duhet zgjeruar hetimet. Hetimet duhet të shkojnë përtej. Duhet parë edhe niveli politik i përgjegjesisë, ministrja Rizvanolli, zonja Dejana Mihali deri tek Albin Kurti.

Ne e kemi parë në komunikimet që ky person, Dejana Mihali del të jetë personi më i fuqishëm në Kosovë pas kryeministrit. Është përfshirë madje edhe në atë se kur Kosova duhet të ketë reduktime e kur jo. Është përfshirë në punësimet. Është përfshirë në komunikatat. Është përfshirë në raportimin kur deputetët i kanë bërë mbi rrjedhjen e mbledhjeve të Bordit të KEK-ut. Dhe, kjo del që është mbi gjithçka. Del madje edhe që të vendos se a duhet të vendos dikush kapela apo jo në takimet me të.

Prandaj, është e domosdoshme që të zgjerohen hetimet. E dyta, ndërmarrjet publike duhet vërtet të kthehen në funksionin e tyre bazik që e kanë në përputhje me mandatin e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj.

Kuvendi i Kosovës duhet të luajë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ia zgjatni pjesën e kohës deputetit Selmanaj, ju lutem, regjia! Regjia, nëse jeni aty, ju lutem!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Kuvendi i Kosovës duhet vërtet ta luajë rolin e tij që ndërmarrjet publike me interes vital të kenë pavarësinë e tyre në ushtrimin e funksionit të tyre dhe mandatin e tyre kushtetues dhe ligjor. Në fund, ju ftojme të mbështesni rezolutën e propozuar nga shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Arben Gashi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Flet kryetari i këtij grupi parlamentar, deputeti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit!

KRYETARI: Regjia, në foltore flet zoti Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar Konjufca!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni në fillim të kësaj seance t'ju rikujtoj Qytetarëve të Republikës së Kosovës se ky është debati i katërt që opozita, kësaj radhe është thirrur me iniciativë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fton Kuvendin e Kosovës si institucionin kryesor në vend të debatojë për tema dhe

skandale, të cilat së paku meritojnë një përgjigje prej njerëzve që janë përgjegjës. Prej atyre që i kanë fituar 50% e na patën lodhur “krejt dhe drejt”. E patën lodhur një popull duke treguar sa të mirë e sa të mençur, e sa të pastër, e sa akademikë janë, e sot, ja, thatë këtu, thatë këtu.

As nuk janë kolegët deputetë të shumicës, e as nuk është asnjëri i Qeverisë së Kosovës që ta thotë një fjalë, ta mbrojë apo ta kundërshtojë, apo ta argumentojë një temë që tanimë është një skandal, jo vetëm për rendin dhe për ligjin, mirëpo është një skandal publik që meriton përgjigje.

Qytetarë të Republikës së Kosovës

Edhe një po e ripërsëris, t’ju tregoj pse jemi ne sot këtu. Pse jemi mbledhur. Pse kemi vendosur ta thërrasim seancën.

Kemi vendosur për shkak se përgjimet që kanë dalë në publik tregojnë për një ndërhyrje të drejtpërdrejtë të strukturave joformale, të strukturave që nuk e kanë asnjë pozicion në shtetin e Kosovës. Të strukturave të cilat, po shihet, janë para-politike dhe ndikojnë në një institucion që është korporata më e madhe energjetike në vend dhe është punëdhënësi, ndërmarrja më e madhe me qarkullimin më të madh financiar shtetëror, e publiku. Pra, e juaja qytetarë të Kosovës.

Sot e kemi thirru këtë seancë për të diskutuar, ta kthejmë, të dëgjojmë pak çka po mendojnë.

Po i shtoj sot pesë pyetje, pesë teza që duhet qytetarët e Kosovës t’i mendojnë, e në veçanti t’i analizojnë këta që po na dëgjojnë prej televizionit, ministrat e Kabinetit qeveritar që e kanë përgjegjësinë, e tash po ikin e po fshihen se nuk ua mban të vijnë e të ballafaqohen me argumente.

Pyetja e parë është shumë e thjeshtë; blerja e energjisë elektrike sipas raporteve zyrtare tregojnë dhe vërtetojnë se KEK ka lidhur kontrata të dëmshme dhe se këto kontrata me tregti të rrymës në shumicën e rasteve janë më bazë të dyshimtë korruptive.

Dhe e dyta, ka raste, po ashtu që këto kontrata janë bërë pa licencë dhe me lidhje të shkurtër të eksponentëve politikë që tanimë emrat e tyre janë publik. Pra, në pyetjen e parë do të duhej të kishim një përgjigje të Kabinetit qeveritar. Qysh ndodh që tregtia me energji në Qeverinë 4-vjeçare të ndodh mbi baza serioze korruptive të inkriminimit edhe prej organizatave që janë me bazë dhe me seli në Beograd, dhe po ashtu pa licencë.

A mund të na tregoni, a mund ta bëni një postim së paku në Facebook, ta thotë dikush prej jush? Po tash nuk flisni se veç edhe dy muaj jeni në Kabinet dhe në përgjegjësitë tuaja.

Pyetja e dytë ndërlidhe me ndërhyrjen e personave joformal në menaxhimin e KEK-ut. A e kuptoni çfarë është duke ndodhur në këtë vend? Kanë dalë në publik komunikime të cilat

vërtetojnë apo do të vërtetohen në procesin e hetimit, se në Kosovë ka vendos kur ndalet rryma e kur lëshohet rryma një njeri, e ai person ka funksion në parti. Dhe, në qoftë se ua ka shkruar krejt fjalimet deputetëve, hallall i qoftë. Por, ai person nuk ka asnjë të drejtë legjitime në një organizatë që është korporatë qeverisëse e shtetit të Kosovës, pasuri e shtetit të Kosovës të na tregojë neve se kur është jetike të ndalet rryma e kur është jo jetike që të mos ndalet rryma.

A e kuptoni deri ku ka shkuar ndërhyrja e personave joformal në menaxhimin e KEK-ut rreth punësimeve që u fol. Si ka mundësi që kush të mos mund t'i bie as kah KEK-u nëse nuk e ka librezën e Vetëvendosjes.

Çështja e tretë tepër e rëndësishme është ndikimi i një individi që ka detyrë partiake që ia ka dhënë Albin Kurti në politikëbërjen e Bordit të KEK-ut.

Kjo pyetje duhet, po ashtu të përgjigjet prej këtyre zotërinjve të bordit që janë në KEK. Për çka jeni aty ju anëtarë të bordit? Për çka rrini? Për ta marrë nga një rrogë a? Jo bre zonja dhe zotërinj. Jeni aty për ta mbikëqyrur një kompani që ka qarkullim 150 milionë euro dhe që është më e madhja në shtet, e jo t'i fusni veshët në lesh, e as të mos dëgjoni e as të mos shihni, sepse kalon edhe kjo Qeveri qysh kanë kaluar të tjerat, e ju do mbeteni me njollë të zezë, e potencialisht edhe ju si përgjegjës për këto çështje.

Pyetja e tretë që shkon për Albin Kurtin, kryeministrin e vendit: çka u bë bre që ti e anulove edhe projektin gazsjellësit amerikan e na le vetëm Kosova është jashtë rrejtit. Në krizën më të madhe energjetike dhatë urdhër që të blihen bateritë.

Krejt bota është duke u munduar me mish edhe me shpirt që të mund të lidhet me Qeverinë amerikane në projekte të ndryshme, që besa edhe armët të blihen prej tyre, ty ta kanë mundësuar që ta kesh një projekt që ta lidhesh gazsjellësin amerikan dhe nuk e ke bërë. Pse e anulove?

E dyta, pse e anulove projektin e "Contour Global"? Na i humbe katër vjet. Na i humbe miliona në arbitrazh dhe e latë KEK-un. Sot, duhet të përgjigjesh pse Kosova B nuk po lëshohet?

Paramendojeni, për shkak të qymyrit që nuk ka rezerva e që po i shisni apo për shkak se nuk po e respektoni kontratën dhe mund të ketë edhe dyshime korruptive. Duhet të na jepni një përgjigje. Nuk po mund ta lëshoni në bazë të kontratës Kosovën B.

Pyetja e katërt: a e dini që ju do të mbaheni në histori për shumë dëme që ia keni bërë vendit? A e dini që ju jeni ata që e keni rritur çmimin e energjisë elektrike, e në fushatë dilje e thoshe, po flemë nën qymyr, po flemë nën thëngjill, shumë shtrenjtë është rryma, shumë bre është rritur çmimi i rrymë. E vet e ke rritur më së shumti. Bile-bile më së shumti ua ke rritur qytetarëve me bllok tarifa, e pastaj edhe bizneseve të cilat mezi po mund të funksionojnë në këtë Qeveri.

Pra, duhet të na tregosh pse e ke rritur. Duhet të ballafaqohesh, të dalësh këtu të na tregosh qysh e rrite çmimin kur thoshe se ne flemë në qymyr, jemi vendi më i pasur.

Pyetja e pestë që shkon, po ashtu për kryeministrin: ju që jeni transparentë e llogaridhënës, e bënit filma, si është e mundshme që ju 105 milionë euro të lejoni të bëhen kontrata sekrete njëburimore në KEK? A jeni more në mend?!

Ato nuk janë para të prindërve tuaj e as të familjeve tuaja, e as të bizneseve tuaja, janë para të popullit, të shtetit. Për 105 milionë euro i keni shpërndarë ku keni dashur pa e hapur në konkurrim të hapur.

Po ashtu, duhet të na tregosh pak, se dilje e flisje këtu filterët e bojlerët, bojlerët e filterët, s'të merrte vesh kush çfarë thoshe. Hajde na trego çka ndodhi me këshilltarin tënd tash që e ke ambasador, Martinin, që dilnit e na lodhnit në fotografi me të. A ke përgjegjësi?

Dhe, në fund, a do të japësh dorëheqje nëse dalin komunikimet tuaja të drejtpërdrejta të cilat kallëzojnë, tregojnë se ke qenë në dijeni për shumë çështje të menaxhimit të KEK-ut. Është turp të mos ballafaqohesh. Vetëm ballafaqimi edhe vetëm e vërteta e lufton një mashtrim historik 4-vjeçar. Faleminderit!

**KYRETARI:** Tash do t'i thërras deputetët sipas radhës në të cilën janë paraqitur. Partia Demokratike e ka radhën tash, dhe flet deputeti Ferat Shala.

**FERAT SHALA:** I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë,

Sot po diskutojmë për prodhuesin më të madh ose kryesor energjetik në vend, për KEK-un.

Ligjërisht dhe moralisht do të duhej të ishte Kabineti qeveritar këtu dhe të bashkëbisedonim me ta, e më së paku do të duhej të ishte ministrja e Ekonomisë, e cila mbulon këtë sektor.

Tani është e qartë, ikja nga përgjegjësia dhe llogaridhënia e ministres dhe vartësve të saj, por edhe komplet Kabinetit qeveritar dhe ministria punën e vetme që po bëjnë në KEK është orvatja që me asnjë çmim, asnjë informacion, aferat korruptive dhe skandalet të mos dalin në publik dhe të mos i kenë mediat.

Ditët e fundit presioni është shtuar ndaj menaxhmentit të KEK-ut dhe punëtorëve në secilin nivel që rrjedhjet e informacionit për situatën dhe skandalet të mos dalin në opinion. Kjo tashmë është bërë përditshmëri në punën e qeverisë dhe të menaxhmentit të KEK-ut. Këtë që po e them po e

ilustroj me një fakt konkret: zjarri që ndodhi, avaria apo eksplodimi në Bllokun A4 Termocentrali A, më 17 tetor 2024, në ndërrimin e dytë, ora 19:12 minuta shkyçet blloku A4 nga puna, për shkak të dëmtimit të tregimit të nivelit të turbinës së majtë. Pas ndaljes së bllokut është intervenuar nga baza e zjarrfikësve në shuarjen e prushit të thëngjillit pluhur. Deri në momentin e ndaljes së bllokut, ky bllok ishte duke prodhuar 126 megavatë/orë. Blloku ftohet sipas udhëzimeve. Ndërrimi i tretë, ora 00:45 minuta pasmesnate, kyçet ventilatori thithës A4, nga personeli i prodhimit hapen dyert e kaldajës, blloku ftohet sipas udhëzimeve, kontrolli i pajisjeve dhe i objekteve. Këto ishin citate dhe pjesë të lexuara nga raporti i KEK-ut zyrtar për ngjarjen që ka ndodhur më datën 17,18 të këtij muaji.

Pra, unë kam bërë postim pas 13 orësh e gjysmë nga shpërthimi dhe avaria në Bllokun A4. Për 13 orë rresht komplet menaxhmenti i KEK-ut ka qenë në vendin e ngjarjes, kanë qenë të informuar Qeveria dhe Ministria për shpërthimin, përkatësisht zjarrin në KEK. Kanë qenë të informuar rreth 70 punëtorë të ndërrimit të dytë, kanë qenë të informuar 70 punëtorë të ndërrimit të tretë, kanë qenë të informuar dhe në punë rreth 40 zjarrfikës.

Pra, në total kanë qenë prezentë dhe të informuar rreth 200 punëtorë të menaxhimit dhe punëtorë të KEK-ut. Asnjë informacion nga KEK-u, as nga Qeveria, asnjë informacion nga ata që e kanë përgjegjësi. Kanë pasur urdhëresë politike që avaria dhe ndalja e bllokut të mbahet larg opinionit. Rreth orës 8 e 30 të mëngjesit, më datën 18, mediat e shumta ishin para zyrave të menaxhmentit të KEK-ut, të Termocentralit A, për të kërkuar informacion dhe mundësi për ndaljen e termocentralit, gjegjësisht për të qenë prezentë në vendin e ngjarjes.

Pse nuk u lejuan mediat të shkojnë në vendin e ngjarjes dhe të shohin situatën? Pse nuk iu dha asnjë informacion derisa nuk u bë publike nga ana jonë? Pse iu deshën më shumë se 15 orë menaxhmentit të KEK-ut për të lëshuar një njoftim për konfirmimin zyrtar të rënies së Bllokut A4?

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar,

Betejat e qeverisë vazhdon edhe sot në ndjekjen dhe hulumtimin se si ka mundësi që opinionin i gjerë dhe mediat e shkruara të informohen për problemet e KEK-ut. Nga data e shfaqjes së zjarrit e deri më sot qeveria ka angazhuar bashkë me menaxhmentin e KEK-ut struktura legale e ilegale, brenda dhe jashtë KEK-ut, për të hetuar, ndjekur të gjithë ata që kanë mundur në çfarëdo forme të japin informacion për këtë situatë edhe këtë e dimë saktë. Është bërë dhe po bëhet presion i madh te punëtorët pse deputeti është i informuar, po as Qeveria e as KEK-u nuk e kanë raportuar ende se sa është dëmi material nga kjo plasje.

Sa ishte dëmi financiar nga ndërprerja e Bllokut A4 për rreth pesë ditë? Sa megavat orë kemi importuar për këtë periudhë kohore dhe çfarë çmimesh kemi importuar? Kërkojmë nga KEK dhe



Ministria e Ekonomisë që të bëjë publike informacionet, raportet zyrtare për të gjitha kostot e kësaj avarie. Në të kundërtën, ne mund t'i bëjmë publike bashkë me mediat e respektuara.

Gjatë këtij procesi përafërsisht Kosova ka humbur rreth 12 mijë megavat/orë energji elektrike. Çka dhe pse duhet shteti t'i mbajë të fshehura këto të dhëna dhe këtë sasi të energjisë së humbur që gjithsesi është importuar për të kompensuar këtë prodhim energjetik. Sa, si dhe nga kush është importuar, mbetet në ditët e ardhshme ta presim se çka na thonë institucionet zyrtare. Edhe një rast shumë i veçantë, i nderuar kryetar dhe të nderuar të pranishëm, sot praktikisht nga data 13 tetor 2024, KEK-u punon pa licencë, edhe ky ndoshta ju duket informacion i ri, por KEK-u zyrtarisht nuk ka licencë nga data 13 tetor.

Pse ndodh kjo kur qeveria tash e 4 vjet e menaxhon edhe me qeverinë komplet, KEK-un, edhe me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Vërtet është shkelje flagrante e Ligjit për miniera dhe minerale dhe është shkallë e lartë e rrezikut në gjithë sektorin energjetik, me theks të veçantë është rrezikuar puna dhe mënyra e funksionimit të minierave të thëngjillit.

Sigurisht që pas këtij lajmi dhe këtij informacioni disa nga kolegët e mazhorancës që sot mungojnë do të shqetësohen si në radhët e skandaleve të tjera dhe do të reagojnë sinqerisht nëse ka dikush që ua shkruan postimet dhe reagimet e tyre.

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë, situata atje është jashtëzakonisht e rëndë, punohet me shkelje ligjore, punohet jashtë çdo norme teknike dhe inxhinierie dhe ndiqen ata që vërtet duan të jenë transparentë dhe llogaridhënës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash prej anës së LDK-së flet deputeti Avdullah Hoti.

Urdhëro, zoti Hoti!

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë këtyre dy jave i kemi mbajtur katër seanca të jashtëzakonshme, të thirrura nga opozita, në asnjërin nga to nuk ka marrë pjesë mazhoranca, për mendimin tim problem fundamental shumë i madh. Janë tema që kemi trajtuar, sepse nuk janë tema që duhet të jenë pjesë e agjendës parlamentare edhe për debate ose interpelanca. Bisedat e mazhorancës për të koordinuar agjendën e Kuvendit me njerëz të kimit, problemet e furnizimit me ushqim të ushtrisë, trajtimi i borxheve të përdoruesve të ujit dhe inkriminimit që ka ndodh aty dhe tash ndërhyrjet parapolitike në KEK.

Unë besoj që sot do të duhej të ishin të gjithë në Kuvend për të debatuar mbi arritjet e qeverisë gjatë këtyre katër vjetëve, sepse është fundi i mandatit dhe është koha kur bëhen bilancet përfundimtare. Prandaj, besoj që salla do të duhej të vlonte sot nga mazhoranca për të mbrojtur punën e tyre katërvjeçare, për të miratuar ligje që presin në Kuvend dhe ligje që janë pjesë e programit të tyre qeveritar për të përmbyllë këtë mandat, ose për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, por askush prej tyre sot këtu nuk është në Kuvend. Tani në një demokraci ku pa përgjegjësi politike, për këto çështje do të duhej të kishte ose dorëheqje të personave të përfshirë në këto çështjet që i përmenda më herët, për të cilat janë thirrur seanca të jashtëzakonshme, ose shkarkim të atyre personave nga kryeministri.

Nëse nuk ndodh as e para e as e dyta, atëherë nuk ka se si të kuptohet ndryshe përveçse përfshirje e plotë prej të parit në Qeveri deri tek i fundi në këto zhvillime të dëmshme për vendin. Sektori i energjisë është i kushtueshëm për qytetarët, për shtetin gjatë këtij mandati, sikurse edhe në mandatet e tjera, por në veçanti gjatë këtij mandati për shkak të krizave energjetike janë shpenzuar qindra miliona euro, por dallimi me mandatet e kaluara është që sot askush nuk e di gjatë këtij mandati sa euro, sa buxhet kemi paguar për fushën energjisë.

As për KEK-un, as për KOST-in, as për qytetarët e bizneset, as për KEDS-in e KESCO-në sa i kemi paguar, as për bizneset private, as për energjinë në Veri. Pse nuk e dimë? Sepse asnjëherë nuk ka pas raportim në këtë Kuvend për këto shpenzime. Dy vjet radhazi unë personalisht e kam përcjellë këtë sektor, kam bërë pyetje parlamentare, jap edhe datat, janë të publikuara në faqen e Kuvendit, asnjëherë s'kam marrë përgjigje. Pyetja ka qenë specifike: ku janë shpenzuar qindra miliona euro? Sa kanë shkuar për KEK-un, KESCO-në, KEDS-in, për Veri, për bizneset e qytetarët? Pra sa keni paguar mjete nga buxheti i shtetit? Përveç shumën totale që e dimë si subvencionim për ndërmarrje publike, që është pjesë e buxhetit, asgjë nuk dimë se sa është shpenzuar në secilën prej këtyre sektorëve.

E, tash shkurt po e them se çka është premtuar në fushën e energjisë nga këtij mandati. Unë i kam përpara premtimet që mbulojnë edhe energjinë, digjitalizimin dhe disa prej sektorëve të tjerë që vijnë brenda Ministrisë së Ekonomisë. Janë nja gjashtë objektiva, premtime të fushës së energjisë, thotë: strategjia e energjisë, është miratuar në këtë Kuvend, por të mos harrojmë është miratuar pa asnjë debat publik e parlamentar dhe krejt fokusin strategjia e energjisë e ka në eficientë e energjisë, jo në krijimin e kapaciteteve të reja energjetike në vend. Premtimi i dytë: plani kombëtar për energji dhe klimë. Unë nuk jam në dijeni, e kam përcjellë këtë sektor nuk jam në dijeni që ka një plan të tillë, edhe nëse ka një plan të tillë në sirtarët e ministrive, nuk e di që ka një veprim konkret në ekonomi nga ky lloj plani.

E treta thotë: masat ambientale në Termocentralin në Kosova B. Shkoni e shihni reagimet e Komunës së Obiliqit, kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe qytetarëve atje, asnjë veprim i vetëm nuk është bërë as për me bërë atë shiritin e gjelbër siç kërkohet me masat ambientale për

termocentrale. Duket në bazë të informatave as obligimet që i ka qeveria, në bazë të Ligjit për Obiliqin, për qytetarët e asaj komune nuk është duke e zbatuar plotësisht.

E katërta thotë: dekomisionimi i aseteve jofunksionale të Kosovës A. Shihni, ky ka qenë premtim, është pjesë e programit të qeverisë. Mandej thotë: studimi i fizibilitetit për zhvillimin e sistemit të gazit natyror, garant u kanë mbetur prej strategjisë kur e kemi bërë qeverinë bashkë, kur kemi qenë disa muaj bashkë. Sepse kur keni ardhur menjëherë në qeveri mandej këtë e keni anuluar këtë projekt. Edhe fondi për efikasitet të energjisë që është shfrytëzuar për të shpërndarë disa miliona te pajisjet për efikasitet të energjisë te qytetarët. Po çka ka ndodhur realisht? Këto kanë qenë premtime, pra çka ka ndodhur realisht në fushën e energjisë? Menjëherë si është marrë mandati është anuluar projekti i gazit dhe është thënë që kanë për t'i dërguar mjetet në projekte më fizibile, por i kanë dërguar në blerjen e baterive. Bateritë e ruajnë energjinë, ne kemi nevojë të prodhojmë energji së pari, e mandej të blejmë bateri e ta ruajmë atë energji.

E dyta, në janar 2022 është dyfishuar çmimi i energjisë. E mandej u bë kaos me vendimet e ZRRE-së edhe gjykatave, e anomalia ishte që kur u lirua mandej energjia në tregjet ndërkombëtare, sepse ky ishte arsyetimi pse u rrit energjia, kur u lirua në tregjet ndërkombëtare, nuk ndodhi kthimi prapa, që të kthehet çmimi i energjisë atje ku ka qenë. Tjetra, u bë subvencionimi i bizneseve për shpenzimet e energjisë, askush nuk e di sa janë shpenzuar. Jemi sharë e fyer ne në qeverinë paraprake pse kemi subvencionuar bizneset gjatë kohës së pandemisë për kokë punëtorit. Ndërkohë, që janë subvencionuar edhe hotele, pompa të benzinës, ambasada, aeroporti dhe gjithçka është subvencionuar për çmimin e energjisë. Edhe nuk e dinë, sepse në pyetjet parlamentare asnjëherë kryeministri dhe ministrja përkatëse nuk janë përgjigjur.

Mandej në mars 2023 u rrit sërish çmimi i energjisë me 15%. Mandej ka filluar subvencionimi i pajisjeve për ngrohje në kulmin e krizës, por kjo s'ka dhënë efekt, sepse KESCO i ka lënë shumë rajone në Kosovë me furnizim njëfazor, që e pamundësoi përdorimin e këtyre pajisjeve që i ka subvencionuar qeveria. Në dhjetor 2023, KEDS i fryn faturat e energjisë, por çka ndodh? Një muaj prapa, në janar 2024, Qeveria ndan subvencione për energji për familjet që bie nuk ka dashur t'ia japë KEDS-it drejt, ua ka dhënë familjeve pas një muaji dhe krejt ato mjete janë paguar në KEDS si fatura të fryra të energjisë. Kriza energjetike është menaxhuar në mënyrë katastrofale, është biseduar këtu në Kuvend për personat që janë shumë më kompetentë për këtë fushë, me ato thirrjet për izolim të shtëpive në kulmin e krizës ose me këshillat komike për heqjen e joystick-ëve nga prizat si masë për ruajtje të energjisë. Ose, lejimi i ngrohjes me thëngjill, duke shkaktuar dëme në shëndetin publik.

Por, problemi a e dini cili është? Zgjatja, tejzgjatja e gjendjes emergjente, që ka zgjatur më shumë se 400 ditë në bazë të evidencës. E, tash kur zgjat kaq gjatë gjendja emergjente, atëherë është krizë energjetike, e kur të bëhet krizë energjetike, bëhet krizë kombëtare, e kur ka krizë kombëtare në energji, atëherë është problem edhe politik, siç na u dëshmuua me këto afera të

shumta të njerëzve të përfshirë. Po kjo a e dini ku ka kulmuar? Prapë në bazë të të dhënave zyrtare të prodhimit të energjisë, ja çka ka ndodhur në dimrin 2022-2023.

Në bazë të Vjetarit të statistikave të Kosovës 2024 për prodhimin e energjisë, thotë: ka rënë prodhimi i energjisë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2020 për nja 300 gigavatë/orë, edhe kjo mandej e arsyeton importin me kontrata, të cilat duket që janë të dyshimta, duke qenë se janë pjesë tash edhe në hetime. Ka plot anomali të tjera që kanë ndodhur ndërkohë në këtë sektor, të cilat ZRRE-ja i ka miratuar në mënyrë të heshtur, ta zëmë, katërfishimi pëlqimeve për këto trafostacionet për biznese, nga 20 euro për kilovat në 90 euro për kilovat, duke rritur koston për një trafostacion për biznese nga rreth 20 mijë euro që ka kushtuar bizneseve, në rreth 90 mijë euro.

Ose marrin një leje ambientaliste për hidrocentralet. Të mos harrojmë sa zhurma është bërë për disa hidrocentrale. Tash lëshohen leje pa asnjë konsultim publik, e reagon komuniteti atje askush nuk merret me atë çështje. E, tash kulmin krejt këtyre iu vendoset me këto ndërhyrjet parapolitike në KEK. Shihni, të nderuar kolegë, në qeveritë e kaluar ka pasur akuza për politizim të KEK-ut, duke vendosur njerëz të politikës në menaxhmentin e KEK-ut. Në këtë qeveri shkohet edhe një shkallë më tutje, menaxhmenti i KEK-ut tash menaxhohet nga parapolitika.

Pra, vendimet merren në zyrat e partive politike, e menaxhmenti atje është vetëm t'i ekzekutojë. Vetëm në kohën e komunizmit kështu ka ndodhur. Në ato poilitbyrotë janë marrë vendimet, zyrtarët publikë e kanë bart funksionin shtetëror, s'i ka pyetur kush, ata veç i kanë zbatuar ato. Kështu është duke ndodhur dhe kjo është dëshmuar.

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjatni pjesën e kohës deputetit Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryetar!

Për ta përfunduar, e vërteta është se mandati po kryhet, katërvjeçar, e nuk ka kapacitete të reja energjetike. Ndoshta kapacitetet e reja energjetike edhe nuk ndërtohen brenda një mandati, por mund të fillohen brenda një mandati, por as nuk janë filluar, as s'është duke menduar kush për këtë çështje.

E vërteta tjetër është se çmimi i energjisë është shtrenjtuar disa herë, dhe nuk është liruar kur u lirua në tregje ndërkombëtare. E vërteta është se janë subvencionuar për energji: hotele, markete, ambasada, aeroporti e shumë biznese të tjera. E vërteta është se janë paguar 113 milionë euro për energjinë në Veri, që është shumëfish më shumë se në qeveritë paraprake, për të cilën janë fyer e janë poshtëruar zyrtarët paraprakë të qeverisë. Sigurisht, zgjidhja për sektorin e energjisë nuk

është e thjeshtë, në të kaluarën sigurisht jemi vonuar në marrjen e vendimeve strategjike për këtë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Atëherë, ia japim tash fjalën deputetit Haki Abazi. Nuk po të shoh, Time, që je lajmëruar, më fal. Po të jep përparësi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë që jeni sot këtu,

Të nderuar media,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot në vend që të diskutojmë për çështje më jetike për qytetarët tanë, ikjen e të rinjve, krizën në sektorin privat, mungesën e sigurimeve shëndetësore, zhvillimin ekonomik apo arsimin, jemi të detyruar të flasim për dështimet dhe keqpërdorimet e Qeverisë Kurti, keqpërdorime të mëdha në sektorin energjetik, në Trepçë, në tenderë njëburimorë dhe në menaxhimin e burimeve publike që prekin secilin prej nesh.

Kjo qeveri do të mbahet në mend si ajo që rikthen krizën energjetike duke na kthyer pas 20 vjet me reduktime të energjisë elektrike. Rriti dy herë çmimin e energjisë për qytetarët e Kosovës, ndërsa për ata në komunat veriore të Kosovës çmimet mbeten të pandryshuara, duke krijuar një trajtim të padrejtë e diskriminues. Veç të flasim për tenderët njëburimorë që janë me miliona dhe që kolegët paraprakë i diskutuan të gjitha me shifra. E pati akuzuar Albini Ramushin, i pati thënë “t’u kanë lig meshkujt”. Po, shih tash “t’u kanë ligë edhe burrat, edhe gratë, je ligë edhe vetë, sepse s’po guxon të vish e të ballafaqohesh me realitetin”.

Ky është realiteti më i mirë i kësaj qeverie dhe a ju kujtohet ajo shprehja që paraluftës shumë herë e kanë përdorur “vrime e miut 300 grosh”. A thua në cilën vrimë të miut është futur në këto momente Albini me të gjithë deputetët që na patën çmendur, që patën thënë: ne e kemi shumicën dhe kemi të drejtë të bëjmë ç’të duam. Bile-bile, ndonjëherë kur abstenonim nëpër komisione parlamentare, mendonin se mund të na përjashtonin edhe prej komisioneve. Bënin kërkesa, sepse nuk e kuptonin se cilat janë të drejtat e tyre dhe kush na përcakton nëpër komisione parlamentare.

Po flitet shumë tash për një Dejonë. A ju kujtohet ajo kënga: e asnjë fjalë s’i shpëtoi o prej goje, por atëkohë kjo këngë i është kushtuar Ganimete Tërbeshit. Ndërsa, tash Dejona Mihali eu asnjë fjalë s’i shpëtoi prej goje, se s’po do t’i tregojë shokët. E shokë e Dejonës, kush janë? Janë Albini, janë Nagip Krasniqi, është ambasadori, sepse këta zinxhir kanë vjedhur. Tash duhet rritur atë burgun e Dyzit, sepse thoshin hajnat në burg. Unë nuk e di a ka kapacitete burgu i Dyzit t’i zë gjithë këta hajnat e Lëvizjes Vetëvendosje.

Tash, komunikimet e fundit nga kjo Qeveri. Kemi avancuar, Mimoza ka avancuar, prej ‘zemljak’ ka dalë në ‘brate’. D.m.th. kanë avancuar se i kanë bërë ‘brate’ këta dhe po dalin përgjimet e tjera, se për zgjedhjen e Presidentes, tash shiheni si ka shkuar zinxhiri dhe si ka qenë komunikimi për të pasur dhe të sigurohen votat për zgjedhjen e Presidentes. Albini e ka thirrur Radojçiqin, Radojçiqi e ka thirrur Radojçiqin dhe Radojçiqi tash i ka detyruar dy deputetë të Listës Serbe të votojnë për zgjedhjen e Presidentes. D.m.th. edhe Kryeministri Albin Kurti paska pasur komunikim të drejtpërdrejtë me Radojçiqin dhe me Vuçiqin, sepse sigurisht atëherë Vuçiqi i ka thënë Radojçiqit: Radojçiq, ‘brate’ ndihmoje ‘brate’ Albinin, se qenka në krizë e të mos shkojë Qeveria, le të vazhdojë kjo Qeveri.

Tash, s’po kanë çka të bëjnë, tash po e akuzojnë Petrit Ajetin. Normalisht që është shefi i AKI-së dhe që është zgjedhur nga votat dhe nga kjo Qeveri, nga Presidentja dhe nga Albin Kurti. Tash, kushdo që fol dhe secili lajm që po del e po buron, tash po e akuzojnë dhe është dal ai tash në sulm edhe në gjah ta sulmojë gjithkënd, edhe mediat, edhe deputetë, edhe të gjithë t’i akuzojë pse po dalin informatat. Po, po dalin informatat, sepse ju keni rrejtur, keni mashtruar dhe keni krijuar opinion për gjithësecilin këtu në Kuvend, për gjithësecilin në Qeveri keni krijuar duke rrejtur, duke mashtruar, ndërsa këto të vërtetat tuaja tash po ju dhembin. Pse të na dhemb neve të themi një realitet ku juve s’ju është dhimbte edhe s’jeni kursyer duke rrejtur, edhe po vazhdoni të rreni, edhe po vazhdoni të mashtroni.

Andaj, kjo Qeveri nuk e ka vendin kund, veç në shpi, edhe besoj se qytetarët janë vetëdijesuar e s’do ta votojnë më këtë Qeveri ‘brate’ e ‘zemlaka’ e këtë Qeveri që po bashkëpunon me Radojçiqin edhe që ishte dashur gjithkrah që kanë komunikuar në këtë periudhë kur ... të organeve të drejtësisë t’i thërrasin në prokurori, sepse vetë organet e drejtësisë së Kosovës e kanë shpallur, Amerika non grata, organet e drejtësisë i kanë ngritur aktakuzë e këta atë periudhë po bashkëpunojnë me ta. Është dashur të përgjigjen para organeve të drejtësisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Abazi tash.

**HAKI ABAZI:** Faleminderit, kryetar!

Besoj që nuk është e këndshme as për ty kjo skena e zbrazët e kolegëve tuaj. Po duket që strategjia për të përjashtuar të tjerët ka përfunduar duke e përjashtuar vetveten prej debatit demokratik. Një institucion më i rëndësishëm në shtetin parlamentar të Kosovës vazhdon të sabotohet nga mazhoranca.

Natyrisht që postulati i këtij pozicionimi ka të bëjë me, hajt të mos shkojmë t’ia mbajmë debatin opozitës, edhe më mirë rrimë e shohim prej televizionit.

Ama, duhet kuptuar shumë drejt që demokracia nuk abordohet kaq lehtë. Pavarësisht se Shqipërinë komuniste e kanë mbajtur për pesëdhjetë vjet të ngulfatur, kanë vrarë edhe

intelektualë aty ku kanë mundur. Në fund të fundit, demokracia i shpëton kësaj tendencës për ngulftatje që është duke ekzistua që sa kohë në Kosovë. D.t.th. ideja për ta zhbërë demokracinë është pikërisht kjo mendësia kur deputetët nuk guxojnë të vijnë të ulen në vendin e tyre.

Unë dua t'i falënderohem publikisht Drita Millakut e Doarsa Kicës e deputeteve të tjerë, të cilët e kanë kuptuar dhe nuk i janë nënshtruar diktatit dhe idesë se nuk guxon të debatosh në demokraci për çështje të cilat janë të interesit publik. Kjo është paradoks, kjo është çmenduri në shekullin XXI, të mos vish të ulësh në karrigen e zgjedhur me votë të qytetarit, veshur me pushtetin e qytetarit, në demokraci të mos guxosh të vishë të ballafaqohesh me argumente dhe me fakte, edhe të mbrohesh për vendimet që i merrni.

Andaj, populli duhet kuptuar, qytetari duhet kuptuar që secili deputet dhe deputete që kërkon votë për Parlamentin e Kosovës, duhet së paku të tregojë integritetin e qëndrimin e pavarur të mendimit politik dhe asaj që e mbron.

Tani, ka kohë e muaj, mos të them edhe vite, që nuk guxojnë të dalin në televizion të thonë asnjë gjë për atë çfarë kërkon qytetari. Tash, së fundmi, edhe në Kuvendin e Republikës nuk guxojnë të vijnë.

Po, t'i kthehem temës së sotme. Sektori energjetik është sektori më i rëndësishëm i një vendi. Këtë debat është dashur ta zhvillojmë në vazhdimësi, ashtu edhe qysh është premtuar, që meqë ndikon në stada afatgjata në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, duhet të ekzistojë edhe një konsensus i brendshëm ndërpolitik për atë, por edhe përfshirë shoqërinë civile, për atë se çfarë drejtimi duhet të marrë sektori energjetik.

Çfarë kemi parë për katër vite, është një sjellje në rreth. Një tentim për të bërë e të përsëritet një të keqe, për të manipuluar sektorin energjetik dhe kompaninë kryesore, Korporatën Energjetike.

Kjo ka vazhduar në kurrizin e qytetarit, në kurrizin e punëtorit, duke e eliminuar Sindikatën e Energjetikës. Një pushtet i majtë i cili nuk i ka lënë vend në asnjë formë sindikatës. Jo vetëm në këtë sektor, në të gjithë sektorët. Janë përjashtuar nga dialogu social të gjitha sindikatat e vendit. As në kohën e Serbisë nuk janë ndalur sindikatat e Kosovës. kanë qenë të pavarura, kanë vepruar të pavarura, kanë dalë jashtë sistemit për të vepruar dhe të mbrojnë të drejtën e qytetarëve dhe të dëgjohet zëri i sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Sot sindikatat janë të përjashtuara nga vendimmarrja dhe dialogu social nga ky pushtet, nga këto vendime arbitrare të individëve të caktuar. Nuk mund kështu një sektor kaq i rëndësishëm ta përjashtojë secilin aktor të veprimtarisë së energjetikes, por e thashë edhe të mjekësisë dhe të sektorëve të tjerë ku sindikatat veprojnë.

Kjo tregon në fakt qartazi që vendimmarrja është mbyllur në duart e një eventualisht dy njerëzve. Në fakt, një njeri i cili mandej i jep urdhër ekzekutimi të të tjerët. Andaj, publikisht po them që duhet lëshuar këtë Krasniqin se është i pafajshëm, përveç faktit që ndoshta ka nënshkruar diçka që i është imponuar. Ama, Nagip Krasniqin duhet lëshuar prej burgut dhe aktakuzës dhe duhet mare atë që e ka sforcuar për të marrë vendime çfarë i ka marrë ai.

Sigurisht. Jo unë mendoj që duhet ta lëshojnë dhe ta marrin në bashkëpunim për t'u gjendur rrënja e problemit. Sepse, nuk është ideja a e dënojmë Nagip Krasniqin, a nuk e dënojmë. Problemi është te kanceri i vendimmarrjes në këtë Qeveri, që merret jashtë institucioneve, prej njerëzve pa autorizim ligjor e institucional dhe vazhdon t'i bëjë viktimë të tjerët. Kjo është mendësia. D.t.th. mendësia është që Kurti, Dejana, Kusari, të gjithë përbrenda krijojnë një klub të cilët sakrifikojnë të tjerët, sikur këta që nuk janë këtu, për të arritur qëllime politike të veta. Po edhe ky nuk është halli. Halli është te funksionimi i demokracisë dhe institucioneve. Halli është te llogaridhënia, transparenca e funksionimit të institucioneve që s'ka qenë kurrë më e ulët dhe jashtë syrit të publikut dhe mediave.

Rrjedhimisht, mendoj që ne duhet ta kërkojmë me ngulm kthimin e demokracisë dhe të funksionimit të institucioneve për llogaridhënie.

Unë dëgjova para disa ditësh Kurtin duke thënë që po i sheh kopshtet e pensionistëve të kthyer nga diaspora. D.m.th. kur t'i mbushin ata 65 vjet, po vijnë dhe po bëjnë kopshte të bukura nëpër Kosovë. Pyetja ime është a po i sheh Kurti pensionistët e Kosovës nëpër kontejnerët e bërllokut duke mbledhur materiale recikluese për t'ia qitur fundin e muajit dhe të paguajnë faturën e energjisë elektrike.

Ai nuk është Kryeministër për të parë pensionistët që i kanë mbushur xhepat me punën e tyre nëpër diasporë dhe kthehen e bëjnë jetë të dinjitetshme këtu, sepse për ata janë kujdesur qeveritë e huaja, shtetet e huaja të zhvilluara. Ai është Kryeministër për të parë kopshtet e pensionistëve tanë, atyre që nuk u del paga, pensioni për të blerë barnat edhe ushqimin e duhur.

Nuk kemi nevojë t'ua bëjmë kopshtet e pensionistëve të Gjermanisë e Zvicrës. E dimë shumë mirë që ata që e kanë lëshuar vendin, kanë shkuar të punojnë diku, kanë krijuar jetë me prosperitet. Ne jemi të zgjedhur për t'i krijuar prosperitet popullit këtu, edhe komoditet, edhe jetë të rehatshme, po besa edhe energji elektrike moderne. Shtatëmbëdhjetë euro është pagesa për shkyçje, që KEDS e aplikon sa herë që mundet për shkyçjen e konsumatorëve. Kush ka dalë në mbrojtje të këtyre konsumatorëve? Nëse tri-katër ditë vonohet një pensionist ose edhe cilado familje në Kosovë të mos e paguajë faturën e fundit të energjisë elektrike, të mos flasim për fatura të mëhershme, të fundit të muajit paraparak, shkyçja dhe kyçja kushton shtatëmbëdhjetë euro, që është përafërsisht gjysma e një fature mesatare të energjisë elektrike në Kosovë. Këta janë njerëzit që duan përgjigje.



Nuk janë ata që kanë punuar në perëndim e në diasporë. Ose mjekët që kanë ikur nga këtu, bëjnë karrierë nëpër Zvicër e Gjermani, edhe na tregojnë qysh është mirë duke funksionuar mjekësia në Kosovë. Jo, jo, duhet ardhur te QKUK-ja, te shërbimi primar dhe sekondar mjekësor në Kosovë. Lërimi këto çështjet e manipulimit të diasporës e të njerëzve që kanë ikur prej këtu. Po të ishin ata patriotët e kontribuuesit, sidomos kjo klasa e cila po bën zhurmë nga jashtë, do të kishim mbetur këtu për t'i ndihmuar vendit dhe ta çojmë vendin përpara. Po, sigurisht ose i është ngulatur mundësia, ose e kanë parë interesin e tyre personal si prioritet.

Tani, kryeministri nuk duhet të frikësohet të vijë në Parlament. E ka bërë një vit që nuk vjen. Ai Kryeministër ka fishkëllyer këtu, ka gjuajtur me vezë, ka gjuajtur edhe gaz lotsjellës kur kryeministrat e tjerë kanë bërë gabime.

Tash, duhet të vijë kryeministri të ulet këtu në vendin e vet, t'u japë llogari qytetarëve: pse ndodh që KEK është në situatën në të cilën është. Si është e mundur që qytetari të diskriminohet prej KEDS-it dhe është plotësisht i pambrojtur. Edhe pse i ka përjashtuar sindikatat prej dialogut social. Këto janë pyetjet që quhet t'i japë Kryeministri, sepse këto janë premtime me të cilat e ka marrë pushtetin.

Ideja që punëtorëve të sigurimit të KEK-ut nuk është bërë edhe sot...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni kohën z. Abazi, ju lutem!

**HAKI ABAZI:** Ideja që për katër vjet është bërë një ankand për energji të renovueshme, edhe atë me kompani që kanë zero përvojë në energjinë e renovueshme. Unë ju garantoj këtu siç është shtyrë për pesë herë edhe ky që është nënshkruar, nuk do të funksionojë, pikërisht për shkak të tentimit të kontrollit se kush e merr ankandin publik për panelet solare.

d.t.th. mungesë totale. Atë që e kam thënë me dhjetëra herë në këtë foltore për strategjinë, e të cilën e kanë quajtur strategji, e nuk është as punim seminarik, me njëzet faqe i bie që ne jemi drejt krizës energjetike sa herë që ndodh një temperaturë më e ulët se -5 gradë atje. Fatmirësisht që vitin e kaluar, fatmirësisht për të thënë, se është ngrohja klimatike, natyrisht që nuk është fat, por fatmirësisht që temperaturat nuk ishin aq të ulëta vitin e kaluar dhe nuk kishim nevojë për import të energjisë elektrike...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni edhe një herë derisa ta përfundojë fjalën z. Abazi.

HAKI ABAZI: Përndryshe për katër vjet, një kilovat orë të energjisë elektrike të renovueshme nuk e ka instaluar Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk po flas për sektorin privat. Ata e kanë bërë vetë me paratë e veta, me burokracinë dhe problemet që hasin në instalimin e këtyre kapaciteteve të energjisë së renovueshme.

Po flas për punën, përgatitjen dhe instalimin e energjisë së renovueshme nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kërkoj falje që u zgjata, po sigurisht që për këtë debat ishte dashur në mënyrë konstante ky Kuvend të bisedojë, e të debatojë e argumentojë, që ne të kemi mundësi të kemi pyetje e përgjigje e të argumentojmë bashkë me ata që kanë marrë vendime.

Natyrisht, i propozoj Kryetarit të Parlamentit ta vendosë një karrige speciale këtu, ta sjellim Dejona Mihalit, edhe ndoshta Dejona di të na japë përgjigje për problemet që i ka Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Tash fjalën po ia jap deputetes Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Të nderuara kolege deputete!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar media,

Zonja dhe zotërinj,

A ju kujtohen parullat e Albin Kurtit në fushatën e kaluar zgjedhore. Hajnat në burg, do ta bëjmë Dubravën dymbëdhjetë kat. Përsëriste si një papagall i lazruar nëpër fushatë dhe squllej në çështjet e popullit që i besonin.

Albini nuk e kishte për synim të arrestojë hajnat e vet, por kërcënonte dhe tentonte të shantazhonte oponentë politikë. Ky ishte skenari i rrenave të Albinit, por ja që skenari i fushatës sot po i kthehet në realitet. Po i kthehet në një realitet të hidhur për aktivistët e vet, të cilët pa asnjë fije turpi zaptuan në mënyrë të paligjshme pozitat e larta në ndërmarrjet shtetërore dhe jo vetëm.

E njëjta tentativë për të shantazhuar kundërshtarët politikë vërehet edhe në paralajmërimet lidhur me materialet e sekuestruara në vilën e Radojçiqit. Çudia është se pse nuk po i bëjnë publike këto materiale.

Këta janë duke e mbuluar, sepse një Qeveri që del dhe thotë kemi gjetur materiale dhe ato materiale po i mbajmë për vete, nuk është një Qeveri normale. Këta duhet të dalin dhe të tregojnë se kë po e mbulojnë në fshehjen e këtyre materialeve. Mund të jetë një grup shantazhuesish, profiterësh, kriminelësh, po kurrën e kurrës një Qeveri që e kanë dëshiruar qytetarët e Republikës së Kosovës.

E keni dëgjuar refrenin e ministrave të Albinit kundër institucioneve tona ligjore. Vazhdimisht kanë sulmuar sistemin e drejtësisë, duke e anatemuar në forma nga më të ndyrat. Dhe për çfarë? Për të vetmen arsye, që Albini nuk arriti të kapte dot këto institucione dhe të arrestojë kundërshtarët e tij. Ka ligje ky vend që nuk ta lejon të arrestosh njerëz vetëm pse i ke kundërshtarë politikë. Ka edhe ca institucione që nuk kapen dot nga askush përveç nga përgjegjshmëria për detyrën shtetërore.

Të nderuar qytetarë,

Nuk e bëri Dubravën dymbëdhjetë kat, sepse krimin dhe korrupsionin në këtë vend, jo që nuk e luftoi, por me hajnat e vet, për katër-pesë vjet ia arriti ta legalizojnë krimin dhe korrupsionin në nivel institucional. Kjo njollë e zezë është e arritura e vetme e kësaj Qeverie që vodhën e shkatërruan pa pikën e ndërgjegjes, qoftë njerëzore, qoftë shtetërore, apo qoftë edhe kombëtare.

Të nderuar qytetarë,

Nagipi vërtet përfundoi në burg, por jo nga Albin Kurti, po nga Prokuroria e Shtetit, nga ajo prokurori që denigrohej në vazhdimësi nga qeveritarët tanë, me theks të veçantë nga Kryeministri Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Në vend që qeveritarët tanë të distancoheshin vërtet nga hajnat, ata filluan një përkrahje në kor sipas regjisë së Dejana Mihalit për mbrojtjen e tyre. Një sjellje e tillë e krerëve të shtetit nuk është normale.

Prandaj, Nagip Skenderi përveç aktakuzës për keqpërdorim të detyrës, hajnisë dhe korrupsionin përmes kontratave njëburimore dhe veprave të tjera si kryeshf ekzekutiv duhet të japë patjetër llogari edhe për lejimin e ndërhyrjes së Dejana Mihalit në këto kompani.

Edhe pse pjesëtarët e pushtetit u bënë dhe do të bëhen copa duke e mbrojtur Dejana Mihalin, sepse duke e mbrojtur Dejonën e mbrojnë Albinin, kjo grua nuk mbart asnjë post institucional.

Prandaj, shtrohet pyetja me çfarë të drejte i fut hundët në institucionet dhe në kompanitë tona shtetërore. Shtrohet, po ashtu pyetja se deri kur e deri ku shtrihet pushteti i saj mbi pushtetin e Qeverisë së Albinit? Sa vendime qeveritare, votime në Kuvend, vepra korruptive, vendime për punësime, e shumë çështje të tjera janë ndikuar nga kjo femër? Me çfarë kompetence vepron Dejana Mihali në Kosovë?

Këto dhe shumë pyetjeve të tjera duhet t'u përgjigjet Dejana Mihali dhe Albin Kurti para Prokurorisë së Shtetit. Kosova nuk është pronë e Albin Kurtit. Albin Kurti ka vetëm një mandat qeverisës. Prandaj, kërkohet hetim të plotë të veprimtarisë së Dejana Mihalit dhe kërkohet llogaridhënie nga Albin Kurti dhe secili që u dirigjua nga kjo femër.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Nga kjo foltore sot dua t'i bëj thirrje Albin Kurtit dhe ministrave të tij që ta ndalin luftën dhe urrejtjen ndaj kategorive të dala nga lufta, e me theks të veçantë ndaj veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Jeni dëshmitarë të gjithë dhe e kemi dëgjuar së bashku ministrin e Financave tek i quan mercenarë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. I kemi dëgjuar përgjimet e Mimoza Kusarit, duke diskutuar me Radoiqiqin për t'i larguar nga lista e pagave minimale.

Kemi dëgjua dhe lexuar fyerjen poshtëruese që i bën Dejana Mihali, duke i quajtur të shkretë në komunikim me Nagip Skenderin. Kjo është e papranueshme dhe e patolerueshme. Prandaj, larg duar nga vlerat e luftës, sepse ua kemi borxh një jetë të dinjitetshme dhe kushte standarde për të jetuar në Kosovë.

**KRYETARI:** Fjalën ia japim deputetes Albana Bytyqi.

**ALBANA BYTYQI:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po më vjen mirë që ke ardhur dhe ta paska dhënë lejen Dejana që të vish këtu sot në seancë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Me të vërtetë është sfidë se nga cili skandal të fillosh kur bëhet fjalë për Qeveri, sepse ata kanë zhytur në korrupsion, nepotizëm dhe afera të shumta, sidomos kur bëhet fjalë për Korporatën Energjetike të Kosovës.

Po filloj me tenderët njëburimorë në KEK, ku prokurimi publik është kthyer në një vatër të korrupsionit pa konkurrencë të drejtë dhe aspak transparente. Këta tenderë të dhënë gjatë periudhës 2021-2024 kanë shkelur parimet bazë të qeverisjes së mirë dhe me duar të papastra kanë favorizuar subjektet e lidhura me pushtetin.

Ky është një model që tregon degradimin e institucioneve publike në interes të grupeve të caktuara dhe individëve që kërkojnë përfitime personale në kurriz të popullit. Rasti i arrestimit të drejtorit të KEK-ut, Nagip Krasniqi për abuzim të pozitës dhe keqpërdorim të prokurimit është vetëm maja e ajsbergut që tregon se në KEK korrupsioni është rrënjësor thellë.

Në këtë kontekst nuk mund të injorojmë faktin se ndërhyrjet e jashtëligjshme politike dhe të individëve të afërt me Qeverinë kanë përshkallëzuar krizën. Sipas raportimeve, Dejana Mihali koordinatorë e Vetëvendosjes ka ndërhyrë direkt në menaxhimin e KEK-ut, në mënyrë të paligjshme dhe të pamerituar. Kjo, jo vetëm që ka dëmtuar integritetin e KEK-ut, por e përçmon idenë e meritokracisë dhe qeverisjes së drejtë për të cilën e kemi pasur gojën plot.

Punësimet e jashtëligjshme dhe ndërhyrjet e jashtme tregojnë se KEK-u është kthyer në bastion të partisë në pushtet, ku vendimet merren për të përfituar të afërmit dhe militantët e tij.

Një aspekt tepër shqetësues që dua ta theksoj është tregtia e energjisë dhe pasojat financiare që kanë prekur direkt qytetarët tanë. Për muaj të tërë Kosova është detyruar të importojë energji për shkak të mosfunksionimit të bllokut A5, një situatë që do të mund të ishte parandaluar me një mirëmbajtje minimale.

Në vend të kësaj, Qeveria ka lejuar që kjo krizë të përkeqësohet, duke e shtyrë vendin të harxhojë miliona euro për importimin e energjisë, ndërkaq që kapacitetet tona të brendshme kanë mbetur të papërdorura.

Vetëm gjatë 11 ditëve të para të prillit të vitit të kaluar, Kosova importoi energji në vlerë mbi 5.4 milionë euro, para me të cilat do të mund të financohej ndonjë punë më e mençur.

Të nderuar deputetë,

Kjo situatë është një pasqyrë e një qeverisjeje të dështuar, ku skemat e korrupsionit dhe interesat mafioze kanë kapur një nga sektorët më vital për shtetin tonë.

Qeveria e Albin Kurtit ka lejuar që KEK-u të bëhet arenë e abuzimeve, favorizimeve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme. Ndërsa kjo situatë nuk po ndalet. Pasojat për qytetarët tanë dhe për ekonominë e vendit do të jenë të pakthyeshme.

Institucionet përgjegjëse duhet të ndërhyjnë urgjentisht dhe të bëjnë një hetim të plotë dhe të thellë mbi keqmenaxhimin në KEK. Të ndalojnë ndërhyrjet e jashtëligjshme dhe të sigurojnë që kjo ndërmarrje jetike të funksionojë në përputhje me ligjet dhe interesin publik. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash flet deputeti Hajdar Beqa. Po ju thërras ashtu siç jeni paraqitur këtu. U takon kolegëve tuaj të jeni më gjenerozë edhe më xhentëlmenë.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që jeni sot prezentë në seancë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Unë konsideroj që debati i ftuar sot është i rëndësishëm së veçantë për qytetarët e vendit, e aq më shumë tani që po hyjmë në sezonin e dimrit dhe e dimë që konsumi i energjisë elektrike do të jetë në rritje dhe kërkesa do të jetë më e madhe nga qytetarët e vendit tonë.

Është për keqardhje që në asnjë debat parlamentar të ftuar nga opozita nuk po vjen mazhoranca. Sot paska ardhur edhe kryetari. E përgëzoj. Deputetja paraprake e pyeti, a ke pyetur Dejonën. Ky

tha nuk po më njohke mirë. Unë po e pyes, kryetar, a ke ardhur me leje apo pa leje të Dejonës? Edhe ishalla nuk ke ndonjë ndëshkim për këtë veprim. Megjithatë, të përgëzoj.

KRYETARI: Ruju Hajdar, se edhe ty të shkarkon Dejona...

HAJDAR BEQA: Shiko, tash! Çka kam parë unë, sa veprimet i ka bërë edhe në KEK, me të vërtet ndoshta i keni dhënë pushtet të madh, e ka kaluar edhe Kushtetutën. Megjithatë, kjo është temë për prokurorinë.

Situata është alarmante në KEK. U tha edhe nga kolegët, kemi keqmenaxhim. Kemi tenderë njëburimore. Kemi kompani që janë ftuar që kurrë nuk kanë qenë në Kosovë, as nuk kanë aplikuar në asnjë punë, s'kanë konkurruar. Këta i kanë gjetur. Sidomos kompani nga Greqia që janë ftuar nga KEK-u. Edhe është mirë që menaxhmenti aktual, se një pjesë janë para prokurorisë, por këta të cilët nuk janë para prokurorisë është mirë t'i tregojnë prokurorit se si i kanë gjetur kompanitë në Greqi, ku asnjëherë pa ardhjen e tyre në pushtet nuk kanë punuar në Kosovë, as në Korporatën Energjetike, po as në ndërmarrje të tjera.

Nuk po flas për transparencë. Nuk po flas shumë për punësime, se po i shohim format, edhe u panë edhe në përgjime se si kanë ardhur ato punësime. Pra, po flasim pak edhe për shpronësime. Kemi deputetë të kësaj mazhorance të cilët kanë interferuar për shpronësime. Kanë shtyrë qytetarë atje të ndërtojnë shtëpitë pas kohës kur u ndalua që të ndërtohet më tutje, dhe edhe ato janë lëndë për prokurori. Dhe, mendoj që Prokuroria e Shtetit dhe policia do t'i marrin masat e veta.

Ne i pamë përgjimet, qytetarë të nderuar, se si Dejona Mihali, një koordinatorë apo një seksere e kryeministrit aktual Albin Kurti si i manaxhon ndërmarrjet. Ka përgjime edhe ka ndërhyrje besoj, që për ndërhyrje kam informata edhe te ndërmarrjet e tjera, që besoj shumë shpejt institucionet gjegjëse do t'i pasqyrojnë para qytetarëve. Pra, e shohim se si ndërhyjnë te Nagipi dhe i thotë eja në zyre. Po ankohen në dosje të tenderit.

Deri në këtë nivel lëshohet, po ankohen kompanitë e tjera në dosje tenderit. A të vijë me kapelë apo pa kapelë. Unë mendoj që edhe kapela edhe maska nuk ka më mundësi t'i mbrojë, jo vetëm para qytetarëve, por as para ligjit dhe drejtësisë.

Nuk e di çka ka pasur të ndërhyjë aty Dejona. Nuk e ka pasur çka ka pasur të ndërhyjnë aty edhe ministrat e tjerë. Nuk po jua ruaj emrat, por janë ministra edhe të dikastereve që s'kanë të bëjnë me energji elektrike. Edhe një rast të caktuar e pyet Nagipi Dejonën, a është vonë ta thërrasim X ministren ose ministrin, që s'ka të bëjë me energji.

Unë kam marrë informata në komision për energji kur isha edhe kryesues. Nuk e keni idenë me sa pasion, këtu ishin deputetët që kanë qenë anëtarë të komisionit, me sa pasion e mbronte keqmeanxhimin, korrupsionin, shitblerjen e energjisë elektrike, e mbronte kryshefi i asaj kohe.

Një deputet, më kujtohet, i mazhorancës që është ende në mazhorancë më pati thënë, tha flisni pak ju bre se ky neve “nuk na bën evelatë” që thotë populli se ky ka raporte të mira me kryeministrin edhe neve nuk na sheh hiç këtu.

Në një moment të caktuar edhe neve deputetët e opozitës, mendonte të sillej njëjtë si me të pozitës, por megjithatë u detyrua në bazë të Ligjit për hetim parlamentar të raportojë dhe t’i jap të dhënat që kërkohen nga komisioni dhe besoj që ato të dhëna më vonë e dimë kanë shkuar edhe prokurori edhe sot po përgjigjen për çështjet të tilla.

Por, kjo nuk është vetëm deri aty, se deri në vitin 2022 kemi hetim. Por, ne e kemi parë që situata është edhe më keq, është tani.

Unë e mora një informatë para se të vij në debat zyrtar, i kam me tabela. E kam këtu konkretisht, furnizimi me qymyr. E kisha bërë një pyetje. Këtu e kemi edhe një ministre që ndoshta ka probleme që të vijë në seancë, po kemi ministrat përkatës që janë përgjegjës për energji elektrike. Pse ka problem me qymyr? Pse për vitin që po hyjmë, tash po hyjmë në sezonin e dimrit dhe nuk ka furnizim me qymyr?

I kam përcjellë tabelat për secilin vit. Në secilin vit në këtë kohë kanë qenë minimumi 2 mijë ton qymyr për secilin termocentral. Tani nuk i kemi as nga 100 tonë. Kujt po i shkon në favor kjo? Tani kur të vjen një situatë e caktuar mungon qymyri. Nuk mund të nxirret qymyri se bie bora dhe nuk mund të hiqet dheu. Andaj, kjo u shkon në favor tregtarëve të energjisë elektrike që po shihen kush janë tregtarët tash. E kemi ambasadorin Berisha e krejt kompaninë e tyre, të mos them, Dejona e s’Dejona, po kryesisht shefi i krejt kësaj tregtie është kryeministri në shkuarje Albin Kurti.

Ne nuk kemi një strategji të mirëfilltë. Kemi një strategji të energjisë elektrike, por nuk kemi as rishikim të asaj strategjie. Kemi, thashë, keqpërdorime tek të gjitha nivelit në KEK. Jemi duke hyrë në sezonin e dimrit, ku i gjithë rajoni ka lëvizur me çmime, do të thotë, i ka zvogëluar çmimet, ne kemi tendenca për rritje të çmimeve.

Andaj, unë do të kërkoja që me të vërtet kjo Qeveri, po shihet se jemi në fund të mandatit, kurrkush nuk i ka numrat që të votojë as rekomandime të kësaj seance, as ligje që vijnë nga mazhoranca. Zgjedhjet po afrohen. 9 shkurti do të jetë afër, por shumë larg për dëmin që po i bëhet vendit nga kjo Qeveri që po shkon.

Nuk po dua të flas për tema të tjera, por është shumë shqetësuese që nga momenti kur doli në pah situata si është koordinuar për tema nacionale, shefja e Grupit të Vetëvendosjes, normal që ajo nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë pa bekimin e kryeministrit Albin Kurti, nuk i pamë këta njerëz më asnjëherë në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Ne e pamë deri në çfarë niveli ka qenë koordinimi, u nga një kriminel është kërkuar të harmonizohet agjenda shtetërore. Nga një krimineli i cili në atë moment kur ka diskutuar me Vetëvendosjen ka qenë i kërkuar nga organet kompetente të shtetit të Republikës së Kosovës.

Unë mendoj që këtu përveç përgjegjësisë morale ka përgjegjësi penale, dhe besoj që organet e rendit ta bëjnë punën e vet. Unë e thërras, tani meqë kryetari i Kuvendit është këtu dhe i takon mazhorancës, që ta ftojë mazhorancën të marrë hapa e të mos fshihemi pas këtyre situatave të krijuara, po të marrim hapa konkret, sepse po na trok në derë një krizë e energjisë elektrike për të cilën fatkeqësisht organet që duhet të marrin veprime nuk kanë integritet për të bërë një gjë të tillë.

Duhet të ndalet, siç thotë populli, sahat e parë, ndërhyrja në institucionet e pavarura, të cilat i kanë bordet, pavarësisht a janë të varura apo të pavarura, se edhe ato borde janë të propozuar nga aksionari, në këtë rast nga kryeministri i Republikës së Kosovës, nga Qeveria, por të ndërhyjnë që të kemi strategji konkrete që ta kalojnë këtë dimër qytetarët me furnizim të energjisë elektrike dhe të mos kemi një rritje të çmimeve, por të kemi një harmonizim të çmimeve siç e kanë bërë edhe shtete e tjera.

Andaj, nuk na mbetet gjë tjetër, përveçse të përgatitemi të gjithë që të shkojmë në zgjedhje, e kjo Qeveri të shkojë në shtëpi, sepse me të vërtetë është duke i dëmtuar interesat nacionale dhe është duke i dëmtuar edhe institucionet që janë ndërtuar me mund e me shumë sakrificë nga shumë breza deri këtu që kemi ardhur sot.

Unë tash po e shoh që shkuan edhe minutat, por të gjitha ndërmarrjet janë keq, e janë ndërmarrjet e tjera që edhe ato gjenerojnë, një pjesë e tyre po shesin edhe sot energji me çmime shumë më të ulëta dhe po blihen energji me çmime shumë të larta. Mendoj që ka vend për organe të hetuesisë edhe këtu. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia jap fjalën tash deputetes Ariana Musliu-Shoshi. Ariana Musliu-Shoshi, urdhëroni!

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,



Sot, është shumë me rëndësi të dimë ne dhe qytetarët se cili është burimi i vërtetë i dështimeve në KEK. A është te sistemi apo është tek individët që e drejtojnë atë.

A e keni kuptuar, qytetarë të dashur, pse kemi pasur reduktime në Qeverinë Kurti, 20 vjet pas luftës? Besoj që e keni kuptuar edhe kush ka vjedhur, e keni kuptuar edhe kush ka përfituar.

Dejona nuk është personi që duhet të amnistohet, Dejona është vetëm një marionetë e Albinit. Pra, përfituesit janë Albini me ministri, me ambasadorë dhe me drejtorë. Këta që më shumë se 50% e qytetarëve u kanë besuar, sot i ikin llogaridhënies para qytetarëve, e në emër të tyre, po ashtu vodhën rezervat shtetërore dhe energjinë elektrike.

E në emrin tuaj, qytetarë të dashur, u nënshkruan jashtëligjshëm mbi 200 kontrata njëburimore. Në emrin tuaj janë rritur çmimet, por jo pagat. Në emrin tuaj u fut Kosova nën sanksione nga BE-ja. Në emrin tuaj u ofenduan veteranët e luftës. Në emrin tuaj, qytetarë të dashur, e me buxhet të shtetit po bëjnë fushatë elektorale e propagandë në Evropë sot, Albini me Donikën dhe me të tjerët.

Kur po diskutojmë për ndërmarrjen më të rëndësishme, pra, KEK-un, e që dikur ishte simbol i prodhimit energjetik, sot punon pa licencë, siç u tha nga profesori Ferat Shala. E që tani në rrugën e falimentimit, është edhe evidente që përgjegjësia për këtë gjendje bie drejtpërdrejt mbi Qeverinë aktuale dhe menaxhmentin e saj të korruptuar dhe të paaftë.

Nën qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje KEK-u është shndërruar në një fushë nepotizmi dhe korrupsioni të pastër. Persona të paaftë, të papërvojë dhe me lidhje të ngushta familjare apo partiake janë vendosur në pozita udhëheqëse, kështu duke e kthyer korporatën në një mjet për interesa personale dhe partiake.

Këta individë që nuk kanë dëshmuar asgjë në fushën e menaxhmentit energjetik dhe elektronik po veprojnë me papërgjegjësi të plotë dhe pa ndonjë mbikëqyrje, duke e sjellë KEK-un, veçanërisht divizionin e prodhimit të qymyrit drejt një kolapsi të sigurt.

Një nga praktikat më shqetësuese që po ndodh sot në KEK, qytetarë të dashur, është punësimi masiv i militantëve partiakë dhe familjarëve të tyre në pozita krejtësisht të panevojshme, e kjo po ndodh sidomos në administratë, duke i tërhequr nga prodhimi ata që kishin përvojë të madhe. Në këtë mënyrë, nuk ka ekspertizë të mjaftueshme në vendet kyçe të prodhimit.

Ndërkohë, projektet kapitale të KEK-ut mbeten të bllokuara në sirtarët e kësaj qeverie, duke sjellë humbje të mëdha financiare dhe shkatërrim të pajisjeve. Kemi shembuj, ku riparimi i vetëm një ekskavatori ka kushtuar 4 milionë euro dhe sot nuk është në funksion. Çka do të thotë

se humbasim edhe garancinë e ofruar nga operatori. Kjo është jo vetëm një dështim menaxherial, por është një vjedhje puro, është hajni, e cila duhet të dënohet me ligj.

Të dashur qytetarë,

Kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më, jemi duke parë një ndërmarrje publike të rëndësishme që po zhytet në kaos dhe keqmenaxhim total, ndërsa Qeveria nuk merr asnjë hap për të ndalur këtë shkatërrim. Në vend të kësaj vazhdon kapja e KEK-ut nga Vetëvendosja, për përfitime politike dhe për përfitime personale. Ne si Parti Demokratike nuk mund të lejojmë që e ardhmja energjetike e Kosovës të jetë peng i korrupsionit dhe i paaftësisë. Kjo Qeveri duhet të marrë përgjegjësi për shkatërrimin e KEK-ut dhe të ndalet menjëherë praktika e nepotizmit dhe kapjes së institucioneve. Ndërmarrja duhet t'u kthehet profesionistëve, dhe duhet t'i nënshtrohet një riorganizimi të plotë dhe transparentë, kështu meritojnë qytetarët tanë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Flet tash deputeti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur temë e diskutimit është një prej ndërmarrjeve më të rëndësishme dhe më vitale në Republikën e Kosovës, siç është Korporata Energjetike e Kosovës, ky duhej të ishte një debat gjithëpërfshirës i deputetëve, sepse nga ajo ndërmarrje publike varet operimi edhe i shumë ndërmarrjeve të tjera dhe i vetë ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kur ata që kanë marrë pushtetin abstenojnë nga debati për keqmenaxhimin në Korporatën Energjetike të Kosovës, kjo tregon që jemi në një situatë kur ata që fituan 51% kanë hequr dorë nga menaxhimi në Republikën e Kosovës, nga udhëheqja dhe qytetarët e Republikës së Kosovës po e shohin tanimë që Vetëvendosje po abstenon nga pushteti dhe nuk është e gatshme as të përballet me dështimet e saj.

Jo vetëm dështimet në premtimet, të cilat i kishte dikur për Korporatën Energjetike të Kosovës që ne flemë mbi thëngjill, por rrymë nuk kemi, tani jemi në situatën kur rryma në Kosovë është e shtrenjtuar 100%, ndërsa hajnia dhe korrupsioni janë shpërfaqur haptazi. Aferat e njëpasnjëshme të korrupsionit, të cilat janë bërë publike dhe për të cilat ka aktakuzë të ngritur, ka të arrestuar, do të duhej pasur një llogaridhënie nga ata të cilët këta persona përgjegjës i emëruan.

Pyetja ime sot është për kryeministrin Kurti, i cili tani ka hequr dorë nga dhënia e llogarisë Kushtetuese para Kuvendit. Deputetët e mazhorancës dhe deputetët në përgjithësi në detyrat e tyre kushtetuese e kanë monitorimin e punës së qeverisë, raportet e ndërmarrjeve publike dhe në këtë situatë kur ti heq dorë nga puna jote si deputet, lëre që nuk ke folur disa nga këta që sot mungojnë këtu që s'kanë folur për katër vjet asnjëherë për asnjë problem të qytetarëve, por heqin dorë edhe nga llogaridhënia e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës.

Pra, të kthehem te ajo te pyetja që unë dëshiroj ta bëj: a është rastësi që Albin Kurti, si kryeministër, me profesion inxhinier i elektros dhe korrupsioni, hajnia, keqpërdorimi, keqmenaxhimi më i madh në qeverisjen e tij ka ndodhur në sektorin e energjisë. Të paktën nëse ka dështuar në shëndetësi, në arsim, në zhvillim ekonomik, në diplomaci, të paktën në sektorin të cilin e ka profesion do të duhej të lulëzonte.

E, çka ka lulëzuar në profesionin e Albin Kurtit? Ka lulëzuar hajnia në energji. Nuk u mjaftuan me shitjen e energjisë përmes ambasadorit fuqiplotë, e mbi të gjitha institucionit të Republikës së Kosovës, zotit Berisha, i cili nga llogaria e tij bankare vetëm në Republikën e Kosovës i ka tërhequr kesh mbi 1,4 milion euro. Më falni, të nderuar kolegë deputetë, më tregoni a dini një person tjetër në Kosovë që ka shkuar dhe i ka tërhequr 1.4 milionë euro kesh nga banka? Cila është arsyeja, pse dikush i tërheq 1,4 milion euro kesh? Tani kemi këtu lloje të ndryshëm të hajnave, njëri që i tërheq 1,4 milion para të GEN-it të Serbisë, dhe kurrkush s'merret me të derisa nuk bëhet publike nga mediat.

Dhe, kemi një tjetër hajn te uji atje që paratë kesh shkon i fut në llogari. Hajni andej, hajni këndeje. Përtej kësaj, pra zoti Nagip Krasniqi i arrestuar për keqpërdorime në KEK, i emëruar nga Bordi i KEK-ut që është emëruar edhe zgjedhur nga Qeveria e Kosovës, nuk shkarkohej nga detyra e kryeshefit me shpresën që presioni publik i kryeministrit Kurti këtu në Kuvend do t'i shtynte organet e drejtësisë që të tërhiqeshin nga akuzat dhe faktet për hajni e keqpërdorime në KEK. Sa e sa hajni tjera janë në KEK, kur riparimi i termocentralit i jepet një kompanie që prodhon dyer e dritare. Paramendojeni! Ata filtrat e bojlerët e Albinit t'i rregullojë e t'i riparojë një kompani, e cila prodhon dyer e dritare. Nuk u mjaftoi as kjo, nuk u ngopën, vazhduan dhe me tenderë të tjerë njëburimorë. Miliona euro të zhvatura të buxhetit të qytetarëve.

Por, gjendja në KEK vazhdon të jetë e rëndë dhe çdo mungesë e prodhimit të energjisë është përfitim i grupeve kriminale të interesit, të cilat janë të lidhura ngushtë me kryeministrin Kurti dhe me deputetë të Vetëvendosjes që dikur hajnin e kishin më të vogël, vidhnin qymyr në traktat e KEK-ut, po tash janë bërë me imunitet të deputetit e imunitet diplomatik, hajninë e kanë rritur në miliona përmes shitjes së energjisë.

Dhe, prandaj nuk vijnë këtu, se janë të njëjtit, janë të njëjtit që dikur kanë vjedhur qymyr duke e qitur dërrasën në traktat e KEK-ut, e tash po vjedhin miliona për veti. Ky është argumenti që opozita e do për debat, e në të cilën kryeministri Kurti duhet të japë përgjegjësi. Po nuk mund të japë përgjegjësi dikush që ka dështuar në profesionin themelor të tij, si inxhinier i elektros. Inxhinieri i elektros dështon në profesionin e tij, se këto të tjerat nuk po i kërkojmë llogari. Për më keq, kur ishin në opozitë, kishin bërë marrëveshje me mediat, premtime elektorale që do ta bëjmë departizimin dhe depolitizimin e ndërmarrjeve publike. A është ky depolitizim e departizim i ndërmarrjes publike kur kryetarja e komiteteve të Lëvizjes Vetëvendosje, Dejana Mihali, i shkruan dhe i aprovon komunikatat për media të KEK-ut.

A është ky depolitizim dhe departizim kur Dejona Mihajli nga zyrat e partisë vendos kur duhet pasur rrymë e kur nuk duhet pasur rrym? A është ky depolitizim e departizim kur Dejona Mihali i thotë kryeshefit ekzekutiv të KEK-ut: “Hajde në zyrë të partisë, veç hajde me kapelë”.

Por, nuk fshihet hajnia me kapelë, u ka dalë mbi kapelë hajnia. Prandaj, edhe s’kanë fytyrë sot të përballen këtu. Përtej kësaj, institucionet tona të drejtësisë e kanë për obligim që të gjitha hajnitë dhe keqpërdorimet t’ i adresojnë me faktet të cilat janë dhe të gjithë ata që abuzuan me pushtetin të përgjigjen para organeve të drejtësisë. Kështu mund të vendosim një sistem të drejtësisë dhe kështu pastaj mund të kthehemi kah zhvillimi ekonomik, duke e ringjallur KEK-un, por jo duke e vjedhur KEK-un qysh po bën qeveria aktuale. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetit Rashit Qalaj.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Të dashur qytetarë,

Është seanca e katërt e jashtëzakonshme për gjendjen e jashtëzakonshme që e kemi në institucionet e Kosovës, në ndërmarrjet publike dhe, thënë të drejtën, edhe për gjendjen e jashtëzakonshme që jemi duke përjetuar ne dhe familjet tona nga skandalet, të cilat kanë shpërthyer në të gjithë resorët e jetës në Kosovë.

Po flasim për Korporatën Energjetike të Kosovës, njëra ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik në këtë vend, të cilën e ka kapluar një hije e zezë, një mjegull dhe e cila është bërë subjekt i shumë hetimeve që janë duke zhvilluar për keqmenaxhimin, për keqqeverisjen dhe për skandalet e ndryshme që janë duke ndodhur aty.

Dhe, për habi, ende ka një rezistencë të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të partisë në pushtet dhe ministrave të saj, duke tentuar që ta mohojnë çdo gjë, çdo skandal, çdo informatë që lidhet me keqpërdorimet dhe duke tentuar që të akuzojnë qeveritë e kaluara në qeverisjet që kanë ndodhur që nga themelimi i këtij shteti e deri më sot. Nëse u kujtohet, të dashur qytetarë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike para dy vjetëve propozoi që të hetohen të gjithë këta zëra të dyshimeve në fushën e energjisë dhe patëm propozuar një komision hetimor parlamentar.

U bë një luftë e madhe këtu dhe u detyruam që të pajtohemi që të formojmë edhe një grup tjetër hetimor parlamentar për situatën me energji që nga viti 2006 deri në vitin 2022. Edhe pse kjo nuk është praktikë parlamentare, sepse gjithmonë grupet hetimore parlamentare formohen për hetimin e dukurive negative, dyshimeve për keqpërdorime e hajni, gjersa një qeveri është në mandat.

Dhe, meqenëse kam qenë anëtar i atij komisioni hetimor parlamentar së bashku me zotin Hajdar Beqa dhe ato kanë qenë të gjitha takime e transmetime publike, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje me një zell të madh filluan të flasin se tani do t'i zbulojmë të gjitha ato që kanë ndodhur për shumë vjet më parë. Vinin në komisione me shumë letra, me shumë vendime, me folderë, me thasë me letra dhe patëm fatin të intervistojmë të gjithë ata që kanë punuar në këtë Korporatë Energjetike që nga fillimi, e sidomos nga viti 2006, me drejtorë e anëtarë të bordit e shumë bashkëpunëtorë të jashtëm e të brendshëm që kanë punuar në KEK dhe arritëm një rezultat, rezultat i cili pastaj rezultoi me fillimin e hetimeve parlamentare për ish-kryeshefin aktual, zotin Nagip Krasniqi, për keqpërdorimet enorme të shumta, të cilat kanë ndodhur në kohën sa ai ka qenë kryeshef i KEK-ut.

Pra, gjithë ai hetim me muaj të tërë intervistomë, nuk u gjet asgjë, por u gjet që zoti Nagip Krasniqi dhe grupi i tij janë pjesë e keqpërdorimeve të shumta. Dhe, nuk mjaftoi me kaq. Prapë eksponentë të Vetëvendosjes, duke filluar nga kryeministri filluan të akuzojnë, të sulmojnë prokurorinë e shtetit pse po i heton dyshimet për hajni, duke aluduar që zoti Nagip Krasniqi është i pafajshëm dhe duke e ditur që ai është i fajshëm deri në fyt. Nga këto komunikimet që ne i pamë tash në publik në mes të zonjës Mihali dhe Nagip Krasniqit, u konfirmua një gjë, nëse e keni përcjellë mediat me vëmendje, në korrespondencat që i kanë pasur në lidhje me publikimet që bënë mediat me aferën e Martin Berishës dhe rolin e tij me blerjen e rrymës dhe GEN-in serb, Nagip Krasniqi i përgjigjet: “Pak a shumë po, janë të vërteta”. Pra, vetë kryeshefi i KEK-ut e konfirmon rolin e ambasadorit në mafinë energjetike të kësaj qeverie në këto 3-4 vjetët e fundit.

Dhe, çka po ndodh sot, të dashur qytetarë. Keni parë aktivizimin e aparatit shtetëror, e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, duke përcjellë paligjshëm gazetarët, të cilët i kanë raportuar këto gjëra nëpër portale dhe kanë diskutuar nëpër debate televizive. Çka po donë sot është që është aktivizuar regjimi për të hetuar punëtorët e KEK-ut, punëtorët e sigurimit dhe të gjithë ata se nga kush i ka marrë informatat deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Ferat Shala, për avarinë e fundit që ka ndodhur në KEK.

Dhe, për më tepër, janë duke shikuar të gjitha kamerat që KEK-u i ka në hapësirat e tyre se mos ndoshta deputeti Ferat Shala ka shkuar fizikisht dhe i ka marrë ato pamje, e ka incizuar avarinë që ka ndodhur në KEK. Pra, paramendojeni deri ku shkon një mentalitet i sëmurë i një regjimi autokratik që e kemi në këtë vend dhe kjo është shumë e papranueshme.

Ndërsa, sa u përket tenderëve njëburimorë. Ne të gjithë në imelat tonë zyrtarë e kemi marrë analizën që ka bërë Info për tremujorin e fundit të këtij viti dhe Info ka gjetur që në këtë tremujor të fundit të këtij viti janë nënshkruar 161 kontrata njëburimore, me përafërsisht apo saktësisht 15 milionë e 870 mijë e 596 e 99 centë.

Pra, nuk i kanë mjaftuar kritikrat e krejt këtij shteti, e krejt këtij populli, e krejt këtyre OJQ-ve, e krejt gazetarëve, e krejt mendjes të shëndoshë të një vendi që kontratat njëburimore janë të dëmshme, por këta vetëm në tre muajt e fundit nënshkruajnë për afërsisht gjashtëmbëdhjetë milionë euro kontrata njëburimore dhe kontrata që realisht i shmangen procedurave, nuk i publikojnë. Pra, kjo më nuk është dyshim, po këto janë fakte të keqpërdorimit të buxhetit të Kosovës dhe kjo nuk ka diskutim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Çka duhet të bëjë opozita më shumë, përveçse të kërkojë debat parlamentar, seancë të jashtëzakonshme dhe të ballafaqojmë faktet me kolegët deputetë që sot mungojnë, që kanë munguar dje, që kanë munguar pardje dhe që janë duke munguar që katër seanca të jashtëzakonshme?

Ju e dini që kur një institucion nuk të kthen përgjigje, atëherë personi që ka bërë kërkesën ka të drejtë, është në të drejtë. Këta deputetë, duke e ditur edhe rolin individual që kanë, meqenëse i kanë ndarë sektorët, dikush e menaxhon KEK-un, po flas për aktivitete të jashtëligjshme, dikush e menaxhon Komisionin për Miniera dhe Minerale, dikush i menaxhon komisionet e tjera, nuk kanë guxim të vijnë këtu dhe të ballafaqohen me opozitën, për shkak se kemi shumë informata.

Jorastësisht, z. Tahiri e përmendi çështjen e shpronësimit në Shipitullë e në shpronësimet që janë duke u bërë në KEK. Ka këtu deputetë me emër e mbiemër, i cili është i involvuar qind për qind në keqpërdorimet për shpronësim, duke ndërtuar dy shtëpi në emër të një djali të mikut të tij, aty ku nuk lejohet shpronësimi.

Pasi u bë publike nga unë dhe kolegu Beqa në Komisionin për Menaxhimin e Financave, ato shtëpi janë rrënuar, ndërsa vendi është shpronësuar, duke mbjellë me mijëra fidanë me një largësi 30 cm, në 30 ha, për t'ia rritur vlerën e shpronësimit. Ai deputeti që ulet atje lart e di, sigurisht është duke na shikuar. Është i njëjti që pas luftës ka pasur pronë të uzurpuar në KEK dhe këtë e ka konstatuar Raporti i Auditimit i asaj kohe.

Prandaj, keqpërdorimet janë të shumta, të rrezikshme, të dëmshme për këtë vend...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Po, urdhëro!

**RASHIT QALAJ:** Ne duhet, është që ne të ftojme deputetët e mazhorancës të vijnë dhe të na i demantojnë këto që po i akuzojmë, me fakte. T'i ballafaqojmë faktet, nëse kanë guxim dhe nëse kanë vullnet dhe nëse i lejon Dejana Mihali, të vijnë në Parlament dhe të diskutojmë për këto akuza që për mua janë të bazuara, janë me fakte për keqpërdorimet.

Fatkeqësisht që jemi duke i përjetuar në këto gati katër vjet qeverisjeje, e cila shpresoj që më 9 shkurt do të ndryshojë dhe kjo qeverisje të mos na përsëritet as në ëndrrat më të këqija që do t'i kemi në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën tash e ka deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të dashur kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Së pari, faleminderit kryetar që je sot me ne, sepse po bëhej shqetësuese kur përveç kolegëve tanë të mazhorancës, edhe ju dukej sikur e keni sabotuar komplet procesin e punës së Kuvendit. Andaj, faleminderit dhe besoj që ky do të jetë rol model edhe për kolegët e tu që të kthehen në vendin e fjalës dhe ballafaqimit për proceset dhe jetën publike në Kosovë.

Aq shumë gjëra po ndodhin brenda një dite, e lëre më brenda një jave, saqë zor e ka njeriu se ku ta nisë e ku ta përfundojë një fjalim. Si duket, këto janë ato copëzat e mozaikut, për të cilat Albin Kurti ka folur gjithmonë, si republika e tjetrit e ne s'i kemi kushtuar vëmendje asnjëherë të vetme. Zakonisht flet për republikën, asnjëherë nuk flet për Republikën e Kosovës. Si duket, sepse ky është ai termi abstrakt i republikës së tretë qysh ai e paramendon e tash ka nisur gradualisht ta zbatojë, si republikën parti-shtet, si diktat direkt ose indirekt.

Krejt çka kemi folur tash e sa kohë në Kuvend, por edhe përmes komisioneve hetimore të themeluara me ngulm në këtë Kuvend, por edhe përmes prononcimeve në minutat jashtë rendit të ditës, apo edhe në deklaratimet tona nëpër media, tani veç ka filluar të jetë në dritën e vërtetë dhe e kristaltë si pamje, mbi skandalet e njëpasnjëshme, edhe në sektorin e energjisë, për të cilin edhe sot është thirrur kjo seancë.

Por, jo vetëm, sepse ka shumë dokumente, komunikime e sinjalizime që kanë dalë këto kohë haptazi. Prandaj, edhe një seri e seancave të jashtëzakonshme po ndodh këto ditë.

Përpara se të flasim për krejt këtë çështje, e për t'u munduar të mos përsëritet mbi ato çka thanë kolegët e mi të të gjitha partive opozitare, më vjen zor ta them, por e mendoj që vetëm në disa seanca të fundit që kanë qenë të jashtëzakonshme lidhen me një pikë nisjeje mbi një grua që është në pozitë. Sikur seanca për rezervat shtetërore, me një grua ministre në sektorin e tregtisë, sikur ajo mbi komunikimin me personin e kërkuar nga shteti i Kosovës, por edhe nga akterët e tjerë, kriminelin Radojçiq, e sikur edhe kjo mbi fenomenet dhe problemet që po ndodhin në Korporatën Energjetike të Kosovës, që lidhet me znj. Dejana Mihali.

Prandaj, kam nevojë që ta shpërfaq një pasqyrë, por edhe ta dekompozoj dhe të shikojmë se a mund ta përthekojmë si mënyrë se si Albin Kurti i përdor njerëzit për politikën e tij ditore dhe jo vetëm.

Si grua e re në politikë e kam parë se sa e vështirë mund të jetë në rrugëtim tonë dhe sa zor e kemi që ne të jemi të vendosur në proceset e tilla, për shkak të dhunës dhe valës që bëhet dhe presioneve të ndryshme që mund t'i kenë.

Secila parti është zotuar të punojë më shumë për përfaqësim e barazi, por askush të jemi të sinqertë, më shumë se Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka arritur këtë, edhe për këtë ia japim kreditin. Duhet të jemi të sinqertë, sepse, edhe në kuptimin e përfaqësimit në Kuvend ka më së shumti gra, si votë e mobilizuar, por edhe në kuptimin e besimit nga jashtë, partia që ka fituar mandatin, thjeshtë ka ardhur në pushtet me 67 për qind të votës së gruas.

Edhe për mua, sot është shumë e rëndësishme të flas se si Albin Kurti e sheh rolin e gruas në procese dhe në politikë. A e sheh si postiere? A e sheh si instrument? A e sheh si ndërmjetësuese? Si inspektore? Apo si platformë të qeverisë në hije?

Mimoza si shefe e grupit zyrtarisht, e Dejana si shefe në hije në prapavijë, Albulena e konfiskimit të pasurisë e shpërfaq mendësinë se si dhe çfarë një grua politike duhet t'i shërbejë Albin Kurtit.

Kjo pamje e grave si prezencë, si votë dhe si instrument, që Albini t'i realizojë idetë e tij të kontrollit dhe diktatit nuk i bën nder asnjë gruajë në politikën. Mua sot më vjen keq për të gjitha koleget e mia, sepse nuk dua që ky të jetë rol modeli i grave në politikë për vajzat dhe gratë e reja që nesër duan të jenë të pjesë e jetës sonë publike politike.

Për Dejonën as që dua të flas, sepse në fakt ajo nuk do të duhej të përbënte as lajm si një anëtare e komiteteve të Lëvizjes Vetëvendosje. Çfarë bën ajo aty brenda, a i kontrollon, a i rrinë gatitu njerëzit brenda, fare pak është e rëndësishme për ne dhe për jetën tonë politike.

Por, për fenomenin Dejana si pushtet paralel të cilin e ka instaluar z. Albin Kurti, si diktat në hije nëpër institucione, si masha dhe dora e zgjatur e tij, nuk mund të mos flasim. Nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e Kosovës shtet që një njeri pa pushtet dhe pa besim të qytetarëve e pa post institucional të infiltrohet e të menaxhojë, e të marrë vendime e të diktojë jetën publike të qytetarëve të këtij vendi. Kjo mendësi e sjell Kosovën në shtet-parti, republika e tretë pra e dëshiruar e Albinit.



Nuk është vetëm ky rast. E kemi parë si në hije disi dhe ka kaluar me shpejtësi rasti i Ridvan Muharremi, apo Rid bukëpjekësit, i cili pa funksion publik, negociacion dhe kontraktin në emër të shtetit të Kosovës për rezervat shtetërore të Kosovës.

Këso lloj gjërash kanë qenë të papara dikur, besa edhe të pamenduara asnjëherë që mund të ndodhin. Pra, po flasim për një stad tjetër të vendimmarrjes që nuk ka qenë dhe nuk është pjesë e rendit tonë kushtetues dhe institucional. Të paktën, nuk do të duhej të jetë.

Një tjetër çështje mbi këtë, për mua përbën reagimi i mazhorancës mbi këto që po ndodhin, duke na fyer secilin deputet të opozitës, e duke na cilësuar me lloj-lloj epitetesh, në mungesë të argumenteve për fenomenet, por edhe në mungesë të ballafaqimit direkt të tyre këtu, sepse nuk vijnë këtu ku duhet të flasim.

E këta kanë ardhur në pushtet me idenë e ndryshimit dhe puna e mirë e tyre në fakt do të krijonte një standard të ri edhe për neve si opozitarë që do të kishim një prag tjetër të punës dhe komunikimit si synim për të ardhmen.

Por, arsytimi i të këqija, abuzimeve të tyre me një të keqe të kaluar, është fundi i tabanit të pafytyrësisë e mendësisë politike. Kjo nuk çon në të ardhme, të jemi të sigurtë. Kjo krijon vetëm një llum e një gropë të zënë në të cilën është futur Kosova, e bashkë me të edhe krejt ne. Dhe, nuk kisha dashur që ta shoh këtë Kuvend edhe Kosovën si të tillë.

Një Kuvend, ku ministrat nuk përgjigjen në pyetje parlamentare qëllimshëm. Nuk vijnë në debate, në seanca. Një Kuvend, ku mazhoranca e mbi 50% të besimit qytetar mungon, në fakt, dezerton me vullnetin e saj apo me diktatin e dikujt, për besë nuk është pamje që do t'ia dëshiroja vendit tim.

As kapelat sot nuk e mbulojnë fytyrën e tuaj të vërtetë në dritën që u ka rënë për t'i zbardhur krejt abuzimet edhe marrëzitë për të cilat ju i ikni llogarisë edhe si Qeveri, edhe si mazhorancë.

Mësymja e rregullt e Lëvizjes Vetëvendosje për ta heshtur këtë Kuvend në forma të ndryshme, duke munguar, duke e pamundësuar diskutimin, duke e mbytur fjalën e lirë dhe argumentin, është veprimi më i rrezikshëm mbi rendin kushtetues.

Njëkohësisht, po e mendoja procesin e shuarjes së strukturave paralele në komunat serbe, e në të njëjtën kohë shtrimin e një sistemi paralel në hije të jetës institucionale shtetërore që e bën Albini si dy vija paralele; njëra për të manipuluar qytetarin, e tjetra për ta kontrolluar shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi. Pra, standarde të dyfishta në çdo sferë.

Andaj, sot duke mos i ripërsëritur krejt marrëzitë e babëzitë e dukuritë negative që janë shpërfaqur kohëve të fundit edhe përmes komisioneve hetimore, po edhe përmes gjetjeve që janë bërë përmes sinjalizuesve, mediave, por edhe deputetëve të Kuvendit në sektorin e energjisë, dua vetëm të theksoj se as nuk mund të presim, e as nuk mund të flasim, se nuk na takon me këtë lloj qasje, mbi tranzicionin e gjelbër dhe energjetik, e as nuk mund të kemi përparim në tregun energjetik e në miksin energjetik, apo në çfarëdolloj adresimi tutje nëse në çdo hallkë të vendimmarrjes për këto procese ka një njëri si Martini, e ka një njëri si Nagipi, si Dejona, e si Albini që janë pjesë e hetimeve dhe e diskutimeve për abuzime.

Një gjë është e qartë, që pushteti nuk vjen veç me mundësitë dhe benifitet. Pushteti vjen edhe me përgjegjësinë dhe llogaridhënien, dhe ne do të jemi këtu dhe do të vazhdojmë të kërkojmë llogari nga ju.

**KRYETARI:** Tash flet deputeti Mërgim Lushtaku. Më fal! Mendova që e ke për fund atë. Arben Gashi flet. Pastaj e ke edhe fjalën e fundit me siguri.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja për të cilën po flasim sot, thënë të drejtën, është ndër çështjet më të rëndësishme në këto 4 vjet qeverisje.

Në këtë orientin dhe mendim, unë duke menduar tash aty ulur, po reflektoja pa në kohë; i vetmi fjalim i kryeministrit të sotëm Albin Kurti që më ka bërë përshtypje gjatë karrierës së tij politike në Kuvendin e Republikës ka qenë fjalimi i tij lidhur me energjinë elektrike.

Më kujtohet, para disa viteve kur patëm bërë një debat në komision hetimor lidhur me privatizimin e distribucionit. Çka më pati bërë përshtypje në atë kohë ishte fakti se ai ishte shumë i informuar për organizimin dhe tregun rajonal dhe ndërkombëtar të energjisë elektrike. Pati folur me emra dhe mbiemra. Mund t'i referoheni arkivave dhe ta shihni diskutimin e kryeministrit të sotëm, Albin Kurti, lidhur me mafinë energjetike.

Përmende emra serbësh dhe boshnjakësh të cilët ishin të përfshirë në tregun e energjisë. Dhe, pritshmëritë e mia për kryeministrin Kurti kanë qenë që në sektorin e energjisë do të jetë i suksesshëm. Kjo ka qenë pritshmëria ime.

I vetmi sektor ku unë kam menduar që ai ka informacion, di për çka po flet dhe e di se si të menaxhohet, pritshmëria ime personale ka qenë sektori i energjisë. Në fakt, aty paska qenë mashtrimi më i madh. Pse? Zoti Kurti vet si inxhinier, është pritur që në aspektin teknologjik dhe të punës së këtyre institucioneve duhet të ketë informacion.

Ju kujtohet ai fjalimi i famshëm në Kuvendin e Republikës, ku nuk mund të blihet filteri para se të ndërrohet bojleri dhe nuk mund të ndërrohet bojleri para se të pastrohet lopata, etj., etj., dhe në fakt mbetem pak si në huti se ndoshta ky po di si inxhinier po flet terma teknike dhe ka diçka këtu. Në fakt, ai kishte qenë duke mashtruar. Kishte qenë duke mashtruar dhe kishte qenë në realizim të planit të tij në fushën e prokurimit publik, duke bërë qindra tenderë njëburimorë dhe sekretë.

Duke u marrë me shitblerjen e energjisë elektrike me kontrata të vërtetuara me vendim të formës së prerë nga gjykata si kontrata të paligjshme. Duke u marrë me menaxhimin direkt të Korporatës Energjetike të Kosovës. Duke treguar se kur duhet të ndalet rryma e kur nuk duhet të ndalet rryma. Duke treguar se kur duhet të hiqen mes dimrit nga prodhimi termoelektranat e Kosovës. Duke përcaktuar çmimin dhe dyfishuar atë. Pra, ky ishte Albin Kurti kryeministër, i cili nëse do të përballej me Albin Kurtin opozitar, a do t'ia thoshte vetes ato fjalë që i ka thënë për sektorin e energjisë elektrike dhe krimin në sektorin e energjisë elektrike në fjalimin e vet në Kuvendin e Republikës.

Çka do t'i thoshte vetes me atë fjalim? Çka do t'i thoshte vetes për tregtinë me energji elektrike? Çka do t'i thoshte vetes për mafinë rajonale? Çka do t'i thoshte vetes për Martin Berishajn? Çfarë do t'i thoshte vetes për Nagip Krasniqin? Çfarë do t'i thoshte vetes për Dejana Mihaljin? Çfarë do t'i thoshte vetes për shitblerjen e energjisë elektrike? Çfarë do t'i thoshte vetes për tenderët njëburimorë? Çfarë do t'i thoshte vetes për nxjerrjen nga prodhimi të termoelektraneve të Kosovës? Çfarë do t'i thoshte vetes kryeministri i sotëm, Albin Kurti, nëse do të ishte opozitari Albin Kurti?

Çfarë do t'i thoshte vetes kryeministri i sotëm, Albin Kurti, për moszbatimin e Ligjit për Obiliqin? Çfarë do t'i thoshte vetes kryeministri i sotëm, Albin Kurti, për mos ndërtimin e zonë së gjelbër ose shiritit të gjelbër të sigurisë për banorët e Obiliqit? Çfarë do t'i thoshte Albin Kurti vetes sot kur janë mbi 800 raste që kërkojnë shërbime mjekësore si rezultat i ndotjes nga KEK-e? Çfarë do t'i thoshte sot vetes opozitari i djeshëm, Albin Kurti, nëse do të ishte këtu që të flas për këtë situatë në KEK?

Çfarë do t'i thoshte Albin Kurti opozitar, kur thoshte se Kosova fle mbi qymyr e paguan energji shtrenjtë, sot, kur si kryeministër thotë, qytetarët e Kosovës as nuk e dinë sa e kanë çmimin e energjisë elektrike, sepse aq i lirë është. Si do të përballeshin këta të dy? Si do të përballeshin?

Unë jam i bindur, nëse diçka kam bindje për këtë Qeveri dhe këtë qeverisje, është se Albin Kurti ka informacion për sistemin energjetik kosovar dhe rajonal. Dhe, nga kush është dilema! Dhe, pse këtë informacion e ka krijuar në gjendje negative për Kosovën? Pse?

Pse është dashur që të dyfishohet çmimi i energjisë elektrike? Pse është dashur që të bëhet tregtimi me negociim të mbyllur dhe i shpallur i paligjshëm nga gjykata? Pse është dashur ta kemi këtë sistem të kontrollit partiak? Pra, sistemi i kontrollit në Korporatën Energjetike të Kosovës është partiak. Shefi partiak i sektorit të energjisë ka qenë shef KEK-ut derisa ka rënë në burg. Dhe, shefi i KEK-ut atëherë dhe shefi i sotëm dhe bordi komplet i emëruar nga kryeministri aktual janë nën kontroll të plotë partiakë.

Po supozojmë me dashamirësi se ka dashur ta shkëpusë prej keqmenaxhimit të kaluar. Po ia japim dyshimin e arsyeshëm dhe po i them; OK, ke dashur ta bësh shkëputjen. A e ke bërë shkëputjen? A e ke emëruar Nagip Krasniqin drejtor të KEK. E ke emëruar bordin qysh ke dashur. E ke emëruar Dejonën si të dërguarën tënde personale që ta kontrollosh KEK-un. Cili është rezultati?

Punësime partiake. Tenderë 103 milionë euro për dy vjet pa konkurrencë, tenderë njëburimorë. Shitblerje të energjisë elektrike pa transparencë dhe me qindra-miliona euro abuzim. Termoelektrana jofunksionale. Ndotje e shtuar e ambientit. Cili është interesi publik këtu? Cili është interesi i Kosovës në të tëra këto veprime të Albin Kurtit?

Cili është interesi i Republikës së Kosovës nën qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje në krye me Albin Kurtin në fushën e energjisë elektrike? Çka ka përfituar Kosova? Çka kanë përfituar qytetarët e Kosovës?

Qytetarët e Kosovës kanë përfituar kancer. Qytetarët e Kosovës kanë përfituar çmim më të shtrenjtë të energjisë elektrike. Qytetarët e Kosovës kanë përfituar humbje të buxhetit të tyre me qindra-miliona euro nga tenderët njëburimorë. Qytetarët e Kosovës kanë përfituar katastrofën ekologjike dhe njerëzore nga kualiteti i ajrit që e thithin çdo ditë.

Kryeministri po harron çfarë ka thënë vet këtu kur ka qenë opozitar, qytetarët e Kosovës e paguajnë dy herë çmimin e energjisë elektrike dhe e paguajnë më së shtrenjti në botë, një herë e paguajnë me para kur e marrin, e herën e dytë e paguajnë me shëndetin e tyre dhe jetën e tyre prej kualitetit të jetës dhe të ajrit që e marrin.

Dhe, tash këtu ia ka shtuar subvencionin, prokurimet njëburimore, punësimet e pamerituara, mungesën e investimeve në Obiliq e të tjera. Por, një gjë që po mbetet pa u përmendur, janë edhe shpronësimet. Qytetarët e Kosovës po e paguajnë edhe me shpronësime për interesa partiake.

Cili është interesi publik këtu? Kjo është tema në të cilën unë kam pritur që Albin Kurti do të jetë ndryshimi. Fatkeqësisht, kjo është tema ku Albin Kurti dhe Qeveria e tij janë katastrofa për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Tash flet Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar deputetë të opozitë,

Të nderuar qytetarë,

Media dhe të gjithë ju që po na ndiqni,

Ka kohë që seancat parlamentare janë shndërruar në arenë të skandaleve dhe të paraqitjes së keqeverisjes së pushtetit të Kurtit.

Ajo që po ndodh sot është kulmi i papërgjegjësisë politike. Seancat që iniciohen që disa herë nga opozita, ndërsa pushteti fshihet, duke i ikur llogaridhënies që qytetari çdo ditë e kërkon.

Njëri prej sektorëve që e ka trajtuar më së keqi nga secili sektor tjetër, është vet sektori i energjisë, siç e përmenden edhe shumë kolegë deputetë. Ata e nisën me manipulime dhe qëllime të errëta, duke e vendosur Nagip Krasniqin në krye të KEK-ut, një njëri që më vonë do të arrestohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ushtrim të ndikimit dhe konfliktit të interesit.

A nuk dëshmon kjo qartazi që emërimi i tij është i kalkuluar mirë për t'u shërbyer interesave të tyre të ngushta kriminale. Sipas Prokurorisë Speciale më 26 janar 2023, Nagip Krasniqi nënshkroi një kontratë të dëmshme dhe të kundërligjshme, e cila e çoi prapa grilave, duke shpërfillur rregullat e prokurimit dhe duke shkelur ato.

Me tenderin e KEK-ut, ai e favorizoi një kompani të caktuar për riparimin e energjisë të një kaldaje me vlerë 3.4 milionë euro, duke i ndryshuar në mënyrë të paligjshme kushtet e kontratës. Këto veprime e çuan vendin tonë drejt një kaosi të energjisë për të cilën qytetarët sot po paguajnë një faturë të rëndë që tejkalon edhe pagën minimale.

Sikur kjo të mos mjaftonte, janë publikuar bisedat e turpshme mes Nagip Krasniqit dhe Dejana Mihalit, koordinatorë e Vetëvendosje, ku kjo ajo e kontrollonte KEK-un dhe në mënyrë të drejtpërdrejt, duke vendosur se kur të ketë reduktime të energjisë dhe kur të mos ketë.

Pra, energjia e vendit është shndërruar në një mjet manipulimi për interesa të ngushta të partisë në pushtet. Qytetarët sot po paguajnë jo vetëm për energjinë që nuk e marrin, por edhe për mashtrime në subvencionet e pajisjeve të eficientës, q ë vetëm thelluan vartësinë nga skemat e blerjes dhe importit të energjisë elektrike.

Të dashur qytetarë,

Qeveria aktuale ka shpenzuar mbi 14 miliardë euro në këto katër vitet e fundi; a ka ndonjë projekt madhor që e mbani mend? A ka ndonjë përmirësim në jetën e përditshme? Besoj, sikurse edhe përgjigjja e shumë prej jush, përgjigjja ime është, jo.

Ajo që ka prodhuar kjo Qeveri janë vetëm skandale, hajni dhe propaganda. Për sa kohë ata përpiqen të fshehin fytyrat e tyre nën kapelë, qytetarët e kanë parë të vërtetën. Dhe, ne nuk do lejojmë që t'i manipulojnë përsëri, sepse e kemi për detyrë që t'ia qesim në sipërfaqe fytyrën e vërtetë që çdo ditë po u bie maska e tyre.

Siç thotë edhe një fjalë e urtë “mashtrimi i ka këmbët e shkurtra” dhe koha e tyre po shkurtohet çdo ditë.

Për fund, i ftoj të gjithë kolegët deputetë nga Vetëvendosje dhe pushteti që të mos frikësohen dhe të vijnë t'i marrin ulëset e tyre, sepse këtu duhet të ballafaqohen me të vërtetën dhe të mos fshihen dhe ikin nga përgjegjësia që kanë. Edhe pse e dinë të vërtetën dhe i ikin asaj, sepse i kanë mashtruar qytetarët me gënjeshtër dhe fjalë të ëmbla, ndërsa po del që ato fjalë janë vetëm me therë dhe po u kushtojnë jo vetëm qytetarëve, por gjithë Kosovës.

**KRYETARI:** Nuk ka deputetë të tjerë që duan të flasin. Me siguri zoti Gashi nuk qenka këtu, por ai besoj që rezolutën e ka paraqitur në fillim, kështu që nuk po e hedhim fare në votim, meqenëse po e shoh që nuk ka numër të mjaftueshëm të deputetëve. Kështu që, vazhdojmë një ditë tjetër kurdo që mbajmë seancë. Po, e paska paraqitur.

Atëherë, kur të krijohen mundësitë për votim në Kuvend, kur të kemi kuorum, e hedhim në votim. Faleminderit!

\* \* \*

*E mërkurë, më 30 tetor 2024*

*Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 24 tetor 2024*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Tani do ta trajtojmë një çështje që e patëm më 14 tetor, e që është:

### **1. Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për skandalet dhe keqmenaxhimi në Korporatën Energjetike të Kosovës**

Edhe rezoluta e fundit është ajo e 24 tetorit për skandalet në keqmenaxhimin në Korporatën Energjetike të Kosovës. Kjo është paraqitur. Pas debatit është paraqitur rezoluta, kështu që mund ta qesim në votim.

Përgatituni për votim, votojmë tash. Vetëm 60. Uluni, sepse duhet t'i japim epilog kësaj. Votojmë tash edhe një herë. 61 vota. Të gjitha kundër. Kështu që, kryhet edhe kjo temë. Mbyllet seanca e 24 tetorit. Mirupafshim në seancën e ardhshme! Çdo të mirë!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*